



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
**-Këshilli Drejtues-**

---

**V E N D I M**

**Nr.1650, datë 29.06.2011**

**Për**

**“Miratimin e dokumentacionit për Implementimin dhe Rregulloren e Zgjedhjes së  
Bartësit dhe Parazgjedhjes së Bartësit”**

Këshilli Drejtues (**KD**) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (**AKEP**), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare të Këshillit Drejtues Znj. Marsida Dushku, në mbledhjen e datës 29.06.2011, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, mori në shqyrtim relacionin shpjegues të Grupit të punës të ngritur me Urdhrin nr. 541, datë 16.03.2010 dhe diskutoi materialin e përgatitur:

- Memo e grupit të punës; (*Memoja*)
- Relacioni shpjegues i akteve të propozuara; (*Relacioni*)
- Projektvendim i Këshillit Drejtues; (*Projekt Vendimi*)
- Dokumentat:
  - o Implementimi i Zgjedhjes së Bartësit dhe Parazgjedhjes së bartësit,
  - o Rregullore për Zgjedhjen e Bartësit dhe Parazgjedhjen e bartësit,
  - o Qëndrimi i AKEP për komentet e palëve të interesuara gjatë konsultimit publik.

## **B A Z A L I G J O R E:**

1. Neni 43 dhe 110 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”;
2. Pika 3.10 e “Udhëzues për procedurat e këshillimit me publikun” miratuar me VKD nr. 1183, datë 10.3.2010;
3. Pika 17 e nenit 21 “Rregullores së Brendëshme të AKEP (ish ERT) miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918;
4. Vendimi i Këshillit Drejtues të AKEP nr.1510,datë 24.02.2011 “Miratimin për këshillim publik të dokumentit: Implementimi dhe Rregullore për Zgjedhjen e Bartësit dhe Parazgjedhjen e Bartësit”;
5. Vendimi i Këshillit Drejtues të AKEP nr.1558 datë 7.04.2011, “Për miratimin e ndryshimit të pikës 2 të dispozitivit të Vendimit nr. 1510, datë 24.02.2011 të KD te AKEP për “Miratimin për këshillim publik të dokumentit: Implementimi dhe Rregullore për Zgjedhjen e Bartësit dhe Parazgjedhjen e Bartësit””.
6. Vendimi i Këshillit Drejtues të AKEP Nr.1348, datë 26. 07. 2010 Për “Përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom Sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese në tregjet me pakicë të telefonisë fikse dhe tregjet me shumicë të interkoneksionit të telefonisë fikse”, i ndryshuar,

## **K Ë S H I L L I D R E J T U E S:**

Nga diskutimi gjatë mbledhjes duke iu referuar dhe bazës ligjore të sipercituar,

## **V Ë R E N:**

1. Në vijim të Vendimit Nr.1510, datë 24.02.2011 Për“Miratimin për këshillim publik të dokumentit: Implementimi dhe Rregullore për Zgjedhjen e Bartësit dhe Parazgjedhjen e Bartësit”, dhe dokumentacionit të publikuar për konsultim publik, në adresë të AKEP kanë sjellë komente palët e interesuara si më poshtë:
  - o Vodafone Albania me shkresat LGD/0100/E.K. datë 30.03.2011 dhe CEO/039/E.Xh, datë 29.04.2011;
  - o Plus Communication me shkresën Nr.176 Prot., datë 29.03.2011;
  - o AMC me shkresën Nr.Prot.1546, datë 30.03.2011;
  - o Albtelecom me shkresën Nr.2046 prot., datë 22.04.2011;
  - o Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit (MITIK) me shkresën Nr.1911 Prot., datë 16.06.2011.
2. Grupi i punës i ngritur me Urdhërin e Kryetarit nr. 541, datë 16.03.2010 ka përgatitur dhe paraqitur për shqyrtim në Këshillin Drejtues dokumentat:
  - o Implementimi i Zgjedhjes së Bartësit dhe Parazgjedhjes së bartësit;
  - o Rregullore për Zgjedhjen e Bartësit dhe Parazgjedhjen e bartësit;

- Qëndrimi i AKEP për komentet e palëve të interesuara gjatë konsultimit publik;
  - Projekt-Vendimin si edhe relacionin përkatës.
3. Projektaktet e përgatitura janë mbështetur në kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi dhe praktikata rregullatore në rajon dhe në vendet e BE, si dhe kanë marrë në konsideratë komentet e palëve të interesuara për dokumentat e nxjerra për konsultim publik nga AKEP, duke bërë ndryshime për sa gjykohet e arsyeshme në dokumentat respektivë. Qëndrimi i AKEP për komentet e palëve të interesuara është parqitur në një dokument të vecantë: *Qëndrimi i AKEP për komentet e palëve të interesuara gjatë konsultimit publik.*
4. Implementimi i Zgjedhjes së Bartësit dhe Parazgjedhjes së Bartësit nga Albtelecom, sipas propozimit të bërë në dokumentin final të përgatitur i shërben rritjes së konkurrencës në tregun e telefonisë fikse dhe përfitimeve të konsumatorëve të këtyre shërbimeve, duke shtuar gamën e shërbimeve dhe mundësitë e zgjedhjes për këta konsumatorë, pra dhe plotësimit të objektivave rregullatore të AKEP.
5. Implementimi i zgjedhjes dhe parazgjedhjes së bartësit përbën zhvillim rregullator të rëndësishëm dhe paraqet interes për operatorët dhe konsumatorët, dhe kjo bën të nevojshme miratimin dhe publikimin e dokumentave:
- Implementimi i Zgjedhjes së Bartësit dhe Parazgjedhjes së bartësit;
  - Rregullore për Zgjedhjen e Bartësit dhe Parazgjedhjen e bartësit;
- Këto dokumenta paraqesin udhëzime dhe rregulla që duhet të zbatohen nga lojtarët e tregut për implementimin me sukses të Z(P)B, të cilat synojn edhe një mbrojtje sa më të mira të pajtimtarëve apo konsumatorëve nga praktika të pandershme të mundshme të operatorëve.
6. Miratimi i dokumentave të cituar në pikën 5, përcakton gjithashtu mënyrën implementimit të detyrimit të vendosur për Z(P)B ndaj Albtelecom me Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP nr.1348, datë 26. 07. 2010.

### **P Ë R K Ë T O A R S Y E :**

Bazuar në pikën 1 të nenit 114, dhe pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918 dhe pikës 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendshme të AKEP,

### **V E N D O S I :**

1. Të miratojë dokumentat e mëposhtëm:
  - a. Implementimi i Zgjedhjes së Bartësit dhe Parazgjedhjes së bartësit;
  - b. Rregullore për Zgjedhjen e Bartësit dhe Parazgjedhjen e bartësit;
  - c. Qëndrimi i AKEP për komentet e palëve të interesuara gjatë konsultimit publik;
2. Ky Vendim dhe dokumentat e referuar në pikën 1, të publikohen në faqen e internetit të AKEP [www.akep.al](http://www.akep.al);

3. Të njoftohet Albtelecom sh.a. për marrjen e këtij Vendimi dhe depozitimin, brenda datës 30.07.2011, në AKEP të amendimeve të ofertës referencë të interkoneksionit për përfshirjen e shërbimeve të zgjedhjes dhe parazgjedhjes së bartësit.

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R I**

**Piro XHIXHO**

**ANËTARË :**

**Alketa MUKAVELATI**

**Benon PALOKA**

**Ibsen ELEZI**

**Zamira NURCE**



**AUTORITETI KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

**QËNDRIMI I AKEP PËR KOMENTET E PALËVE TË**

**INTERESUARA PËR DOKUMENTIN:**

**Implementimi dhe Rregullore**  
**për Zgjedhjen e Bartësit dhe Parazgjedhjen e Bartësit**  
(KONSULTIM PUBLIK : 24.02.2011)

**Tiranë më \_\_.\_\_.2011**

Në përfundim të procesit të konsultimit publik për dokumentin *Implementimi dhe Rregullore për Zgjedhjen e Bartësit dhe Parazgjedhjen e Bartësit*, i cili është miratuar me VKD nr.1510, datë 24.02.2011, nga palët e interesuara kanë dërguar komente në AKEP:

- Vodafone Albania me shkresat LGD/0100/E.K. datë 30.03.2011 dhe CEO/039/E.Xh, datë 29.04.2011;
- Plus Communication me shkresën Nr.176 Prot., datë 29.03.2011;
- AMC me shkresën Nr.Prot.1546, datë 30.03.2011;
- Albtelecom me shkresën Nr.2046 prot., datë 22.04.2011;
- Ministria për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit (MITIK) me shkresën Nr.1911 Prot., datë 16.06.2011.

Dokumenti i AKEP, *Implementimi dhe Rregullore për Zgjedhjen e Bartësit dhe Parazgjedhjen e Bartësit*, ka dalë në konsultim publik në faqen e internetit të AKEP me datë 24.02.2011 dhe palëve të interesuara i'u la rreth një muaj kohë, deri më 31.03.2011, për të dërguar komentet e tyre. Në vijim të kërkesës së Albtelecom për shtyrje të afatit të konsultimit, AKEP miratoi zgjatjen e periudhës së konsultimit publik deri më 30.04.2011.

Në këtë dokument paraqitet qëndrimi i AKEP për komentet e palëve të interesuara për dokumentin e nxjerrë për konsultim publik.

AKEP, në dokumentin e nxjerrë në konsultim publik, *Implementimi dhe Rregullore për Zgjedhjen e Bartësit dhe Parazgjedhjen e Bartësit*, kishte shtruar disa pyetje të cilat u gjykuan si më kryesoret dhe më të rëndësishmet për procesin e komenteve nga ana e palëve të interesuara, si më poshtë:

**Pyetje 1: Cili është opinioni i palëve të interesuara në lidhje me propozimin e AKEP për implementimin e Z(P)B fillimisht vetëm për Albtelecom?**

**Pyetje 2: A janë dakort palët e interesuara me propozimin e AKEP për implementimin me dy faza Z(P)B dhe afatet e tyre?**

**Pyetje 3: Cili është opinioni i palëve të interesuara për kategoritë/alternativat e thirrjeve për parazgjedhje të bartësit dhe llojet e thirrjeve të përfshira në secilën kategori/alternativë?**

**Pyetje 4: Cili është opinioni i palëve të interesuara në lidhje me aplikimin e tarifave fikse (përveç tarifave të origjinimit të thirrjeve) dhe çfarë nivelesh tarifash gjykohen si të arsyeshme. Me këto komente ju lutem përfshini edhe justifikimin për nivelin e propozuar?**

**Pyetje 5: Çfarë mendojnë palët e interesuara në lidhje me parashikimet e draft-rregullores për Z(P)B në lidhje me mbrojtjen e konsumatorëve? A janë ato të mjaftueshme? Cilat janë propozimet tuaja për përmirësimin e tyre dhe/ose kuadrit mbrojtës të konsumatorit për Z(P)B?**

**Pyetje 6: Cilat janë komentet tuaja në lidhje me alokimin e numeracionit për bartësit e thirrjeve?**

**Pyetje 7: Cilat janë komentet tuaja në lidhje me draft rregulloren për Z(P)B? Komentet janë të mirëpritura për çdo përcaktim të draft rregullores.**

Më poshtë AKEP paraqet komentet kryesore të operatorëve për secilën prej pyetjeve të konsultimit publik dhe qëndrimin e AKEP për komentet e dërguara.

**Pyetje 1: Cili është opinionin i palëve të interesuara në lidhje me propozimin e AKEP për implementimin e Z(P)B fillimisht vetëm për Albtelecom?**

Albtelecom nuk është dakord që implementimi të fillojë fillimisht vetëm për të. Detyrimi për Z(P)B duhet tu vendoset edhe sipërmarrësve të tjerë, për sa kohë që ky detyrim, në zbatim të parimeve të ligjit për komunikimet elektronike, vendoset në përfitim të përdoruesit fundor. Gjithashtu, me vendosjen e këtij detyrimi ndaj të gjithë operatorëve konkurenca do të ishte me e madhe dhe do të promovojë efektivisht, për sa kohë që të gjitha operatorët do të vendosnin tarifa të tilla që të tërhiqnin klientet. Ndërkohë që duke e vendosur këtë detyrim vetëm ndaj Albtelecom, do të thoshte që Albtelecom të subvencionojë akoma më tej operatorët e tjerë në zhvillimin e biznesit të tyre duke i vënë në dispozicion pajtimtarët e tij dhe kjo nuk mund të quhet promovim i konkurrencës.

Tre Operatorët celularë shprehen dakort me këtë qëndrim të AKEP për implementim të Z(P)B fillimisht për Albtelecom. Plus kërkon që njëkohësisht të këtë procedura dhe detyrime të qarta, ndërsa Vodafone shprehet se implementimi kësaj mase është i vonuar duke iu referuar nevojës së tregut të telefonisë fikse, e cila sipas të dhënave të publikuara nga AKEP evidenton mungesën e konkurrencës në këtë treg, si dhe faktit që detyrimi është vendosur në Korrik 2010. Vodafone kërkon gjithashtu implementimin e masave të tjera rregullatore ndaj Albtelecom si LLU dhe linjat me qera për të cilat AKEP nuk ka marrë ende vendime.

AMC dhe Vodafone kundërshtojnë mundësinë e vendosjes së këtij detyrimi për operatorët celularë duke e konsideruar në kundërshtim me praktikën europiane, ku direktivat e KE dhe praktika në BE dhe rajon i referohen këtij detyrimi si ekskluzivisht për telefoninë fikse.

#### **Qëndrimi i AKEP:**

*AKEP gjykon se nuk është e nevojshme që të ndryshojë qëndrim për mënyrën e implementimit të Z(P)B, duke filluar me Albtelecom. Për sa i përket Z(P)B në rrjetet celulare dhe referencave me direktivat e KE, ky diskutim është bërë tashmë në analizën e tregut të telefonisë celulare në vitin 2010, ku është theksuar se direktivat e KE, vërtet përcaktojnë këtë detyrim për operatorin me FNT në telefoninë fikse, por nuk përjashtojnë mundësinë e vendosjes për operatorët celularë. Megjithatë AKEP ka bërë disa sqarime shtesë për këtë pikë në dokumentin final: Implementimi i Zgjedhjes së Bartësit dhe Parazgjedhjes së Bartësit.*

**Pyetje 2: A janë dakort palët e interesuara me propozimin e AKEP për implementimin me dy faza Z(P)B dhe afatet e tyre?**

**ALBTELECOM:**

Afati për Fazën I (dt. 01.05.2011) është absolutisht i pamundur objektivisht për tu realizuar nga ana e Albtelecom, për arsye të mëposhtme:

- Kërkohen investime të nevojshme për të mbështetur implementimin e shërbimit Z(P)B.
- Kërkohen përgatitjet respektive në sistemet e Albtelecom (centrale, rrjete, billing).
- Duhet përgatitur konfigurimet përkatëse në centralet e Albtelecom.
- Duhet bërë konfigurimet dhe përgatitjet përkatëse në sistemin e billingut.
- Duhet përcaktuar procedurat dhe stafi përkatës në aspektin administrativ që do të menaxhojë Z(P)B, duke filluar që nga marrëdhënia me operatorin e deri tek marrëdhënia me pajtimtarin. E gjithë kjo kërkon disa procese pune që përfshijnë koordinimin mes disa Drejtorive në administratën e brendshme të Albtelecom.
- Duhet trajnuar stafi përkatës për implementimin dhe menaxhimin e Z(P)B dhe të hartohen rregulloret e brendshme përkatëse për mirëfunksionimin dhe implementimin e Z(P)B.

Për të gjitha këto më sipër, objektivisht nuk mjafton koha, - ndërkohë që dokumenti rregullator përkatës, si e parashikon ligji, është ende në këshillim publik. Albtelecom e sheh të pamundur fillimin e Fazës I të paktën deri në **1.12.2011**

**AMC:**

Afatet e implementimit të CS/CPS zgjasin më shumë se një vit pasi kërkojnë një përgatitje të infrastrukturës dhe upgrade në rrjetet përkatëse, të cilët kërkojnë kosto të larta (set-up implementation costs që duhet të përballohen nga Operatori Incumbent) deri në plotësimin e të gjitha kapaciteteve teknike.

Rregullimi final i këtij shërbimi duhet të marrë parasysh dhe disa faktorë të tjerë të rëndësishëm që kërkojnë një kohë të gjatë në trajtimin e tyre. Implementimi i para-zgjedhjes së bartësit do të përfshijë:

- kushtet dhe kapacitetet teknike të rrjetit dhe të pjesëve të tjera të infrastrukturës;
- krijimi i linqeve të transmetimit dhe pikave të interkoneksionit;
- përgatitjet për sistemin e menaxhimit të marrëdhënieve me klientin;
- përgatitjet për sistemin e faturimit;



- rregullimet përkatëse në marrëveshjet e akses/interkoneksionit (duke përfshirë dhe garancitë për pagesat);
- caktimi i një date fillimi të koordinuar ndërmjet palëve dhe një periudhë e implementimit të këtij shërbimi e realizuar në disa faza;

Gjendja e rrjetit dhe e infrastrukturës e nevojshme për implementimin e shërbimit të para-zgjedhjes së bartësit influencon të gjitha switch-et e rrjetit (përfshirë testime të ndryshme për kapacitetet teknike). Si e tillë, çdo gabim ose defekt gjatë kryerjes së ndërhyrjeve në rrjet do të shkaktonte problem e cila ndikon drejtpërsëdrejti dhe në afatet kohore për implementimin e CPS.

Problemi i ofrimit të këtij shërbimi nga operatorët e telefonise fikse kërkon dhe një proces licensimi, i cili në qendrat e mëdha urbane mund të realizohet brenda afateve të kërkuara, por që mbetet e vështirë për tu realizuar në zonat e largëta rurale ku mungon infrastruktura dhe kushtet teknike për implementimin brenda kohës së kërkuar të këtij shërbimi.

Probleme të tjera lindin dhe në procesin e menaxhimit të marrëdhënieve me klientin, i cili duhet të jete në gjendje të modifikojë dhe të fshijë regjistrimet e zgjedhjes dhe para-zgjedhjes së bartësit. Sistemi i faturimit në nivelin retail i ofruesit të CS/CPS ka nevojë për ndryshime në mënyrë që të mos faturohen thirrjet që përfshihen në shërbimin CS/CPS. Ndryshime të tjera mund të lindin dhe në sistemin e administrimit të faturimeve ndërmjet operatoreve për faturimin e operatoreve që ofrojnë shërbimin e para-zgjedhjes së bartësit.

Probleme të tjera mund të lindin dhe nga humbje të mundshme të abonentëve që përdorin këto mekanizme, ose nga transferimi i të dhënave të klientëve të shkaktuara nga përdorimi i këtij shërbimi.

Gjithashtu, implementimi i CPS në disa vende ka zgjatur për më shumë se dy vjet dhe ky proces ka disa ngjashmëri në aspektin e marrëdhënieve ndërmjet operatoreve që është shfaqur gjatë implementimit të portabilitetit të numrit. Albtelekom si operatori kryesor në ofrimin e shërbimit të CS/CPS nuk është akoma gati për ofrimin e procesit të portabilitetit të numrit, dhe ky fakt duhet të merret parasysh për afatet e vendosura për implementimin dhe hedhjen në treg të shërbimit CS/CPS nga ky operator.

Për sa përshtruan dhe më sipër, duke marrë parasysh të gjithë këta faktore, mendojmë që afatet e parashikuara për tu bërë implementimi i plotë i këtij shërbimi nuk mund të realizohen ashtu siç kërkohet në këto dokument për konsultim publik (brenda një harku 1-vjeçar). Ne sugjerojmë që këto afate të rishikohen dhe të përfshijnë një periudhë kohore të pakten 2-vjeçare për implementimin e shërbimit CS/CPS, pasi kjo është dhe eksperiencë që kanë pasur shumë vende të tjera në realizimin e plotë të këtij procesi. Gjithashtu, sugjerojmë që ky proces të përmbajë më shumë se dy faza për shkak të kompleksitetit dhe vështiresive në implementimin e tij si dhe në impaktin që do të ketë mbi abonentët. E rëndësishme është që në këto faza të trajtohet dhe problemi i edukimit të abonentit, i cili rrit më tepër vështirësinë e këtij procesi.

Me poshte kemi sjelle dhe disa evidence ne lidhje me kohe-zgjatjen e implementimit te procesit te Zgjedhjes/Para-Zgjedhjes se Bartsit.

Ne BE, pas miratimit te Interconnection Directive 1997, ky sherbim ka filluar te implementohet ne vende te BE-se ne '98 dhe per 8 vendet e para eshte bere i disponueshem brenda 2001 (psh.: Itali, Belgjike, Angli, etj).

Ne Angli, konsultimi publik per kete ceshte ka filluar ne 1998 dhe implementimi eshte kerkuar te perfundoje per nje afat kohor 2 vjecar (January 2000). [Carrier Pre-Selection in the UK-Consultative Document, July 1998]

### **Plus Communication:**

Sugjeron se afatet e dhëna në konsultim publik janë të shkurtëra pasi implementimi kërkon ndryshime në rrjet, RIO si edhe konsultime midis palëve të interesuara për proceset.

### **Vodafone Albania:**

Ne kete pike ka vetem komentin qe procesi te implementohet me shpejtesi optimale qe te realizohen efektet e mundshme pozitive ne dobi te konsumatoreve, pa kaluar ne afate te tejzgjatura prej nje viti. Kujtojmë se per nje proces po kaq kompleks, portabilitetin e numrit AKEP kerkoj qe operatoret celulare ta implementojne ne 4 (kater) muaj pa marre ne konsiderate komentet e operatoreve celulare per pergatitjen e nevojshme teknike dhe operacionale dhe investimet perkatese. Vodafone kerkon qe AKEP te mos zbatoje dy standarte per trajtimin e operatoreve ne treg dhe te trajtoje me te njejten menyre mirekuptimi ose jo te argumenteve teknike si per operatoret fiks dhe ata celulare, pa krijuar diskriminime pozitive apo negative..

### **Oëndrimi i AKEP:**

*Duke marrë në konsideratë komentet e palëve të interesuara, AKEP ka bërë ndryshime në afatet e implementimit nga Albtelecom si më poshtë:*

- Faza e I: duke filluar nga 15.10.2011.
- Faza e dyte: duke filluar nga 1.05.2012.

**Pyetje 3: Cili është opinioni i palëve të interesuara për kategoritë/alternativat e thirrjeve për parazgjedhje të bartsit dhe llojet e thirrjeve të përfshira në secilën kategori/alternativë?**

### **AMC:**

Një sugjerim mund të ishte nje kombinim i Default Carrier me tekniken e Call-by-Call basis qe mund te eliminonte kostot e teperta dhe do te rriste konkurrencen ne treg (duke u dhene

me shume mundesi te gjithë operatoreve per te kerkuar kete sherbim me kosto sa me eficente dhe me mekanizma me te thjeshte te implementimit).

Mendojme qe implementimi i para-zgjedhjes se bartesit te aplikojë nje metodologji “multiple approach”, per arsyen se disa operatore ofrojne vetem sherbime nderkombetare te terminimit dhe operatore te tjere qe ofrojne vetem sherbime te terminimit kombetar. Gjate kesaj faze mund te lindin probleme teknike te cilat duhet te adresohen ne fazen e upgradimit te sëitch-eve per implementimin e CPS.

Ne sektorin e thirrjeve nderkombetare parashikohet nje konkurrence me e madhe dhe me e ashper ne lidhje me perpjekjet e operatoreve per te fituar sa me shume trafik per tu rrugezuar ne rrjetet e tyre (psh. nepermjet njoftimeve dhe publiciteteve ne media dhe ne TV per evidentimin e oreve favorizuese per destinacione specifike te disponueshme per disa operatore me cmime shume te ulete). Nje oferte e tille per abonentet qe kane zgjedhur sherbimin e para-zgjedhjes se bartesit mund te jete e veshtire, pasi kostot dhe administrimi i ndryshimit te zgjedhjeve te tyre per bartes te ndryshem ne nje kohe te shkurter mund te rezultojë e papraktikueshme.

### **Vodafone Albania:**

Veren se ne te gjithë shembujt e paraqitur nga AKEP ne vendet e rajonit nuk rezulton qe implementimi i Z(P)B te kete filluar nga thirrjet nderkombetare. Ndaj, ne shprehim interesin te dime se perse AKEP ka zgjedhur pikerisht kete forme implementimi te procesit, dhe jo sic ka ndodhur random ne vendet e rajonit, ku faza e dyte i ka takuar pergjithesisht thirrjeve lokale, nderkoheqë gjate fazes se pare eshte realizuar Z(P)B per te gjithë llojet e tjera te thirrjeve.

### **Plus Communication:**

Shprehet se duhet përcaktim më i qartë i thirrjeve lokale si dhe për shërbimin roaming në rast të implementimit për operatorët celularë të Z(P)B. Gjithashtu Plus sugjeron që thirrjet kombëtare të ndahen:

- Thirrje kombëtare linjë fikse lokale
- Thirrje kombëtare linjë fikse jo-lokale
- Thirrje kombëtare celulare

### **Qëndrimi i AKEP:**

*AKEP në përcaktimin e kategorive të thirrjeve është mbështetur në përvojën e rajonit dhe të vendeve të BE si Mbretëria e Bashkuar, si dhe karakteristikat e tregut shqiptar. Për këtë arsye, AKEP nuk e gjykon të nevojshme kategorizime të tjera të opsioneve për Z(P)B.*

**Pyetje 4: Cili është opinioni i palëve te interesuara ne lidhje aplikimin e tarifave fikse (pervec tarifave te origjinimit te thirrjeve) dhe cfare nivelesh tarifash gjykohen si te**

**arsyeshme. Me keto komente ju lutem perfshini edhe justifikimin per nivelin e propozuar?**

**Albtelecom:**

Kerkon te aplikohen pagesat sipas kategorive te meposhtme, pasi implementim i Z(P)B do te shkaktoje kosto te medha financiare ndaj Albtelecom. Per te qene transparent, Albtelecom ka kategorizuar llojet e pagesave sipas kostove qe i shkaktohen.

- 1) per cdo operator (nje here) per vendosjen fillestare te aksesit ne rrjet per kete sherbim, per te konfiguruar sistemet per te mbeshtetur Z(P)B per kete operator
- 2) pagesa per origjinimin e thirrjeve
- 3) pagese mujore ndaj operatorit duke filluar qe nga data kur eshte bere transaksioni i pare per te mbuluar koston e menaxhimit "live" ne vazhdimi te ketij produkti nga ana e operatorit te aksesit.
- 4) pagesa per administrimin e kerkesave, (aktivizimin/ndryshim/anullimin/pezullimin) e Z(P)B per cdo pajtimtar, per te bere konfigurimet perkatese ne sistemin e operatorit ofrues te aksesit qe te mundesoje cdo pajtimatri (aktivizimin/ndryshim/anullimin/pezullimin) e Z(P)B
- 5) pagese per konfigurimin e kodit perkates per Z(P)B te Operatorit bartes
- 6) pagese per minute (surcharge per minute) qe rrjeti te rikuperohet nga kostoja e shkaktuar rrjetit per te mundesuar Z(P)B. Kjo pagese do te vazhdoje per nje periudhe prej 5 vjetesh (e ndryshueshme) deri sa te rikuperohen koston e tij. (ref: British Telecom, Ofcom)

**AMC:**

Ne lidhje me aplikimin e tarifave per sherbimin e zgjedhjes dhe para-zgjedhjes se bartesit nuk kemi komente per te shtuar, pasi aktualisht nuk ka referenca dhe evidence te sakta per nivelin e ketyre tarifave ne vende te tjera te BE-se dhe te rajonit, si ne raportet vjetore te Komisionit European per telekomunikacionet, apo ne raportet e Cullen International per vendet e rajonit.

**VODAFONE:**

Ne vijimesi te komenteve te mesiperme ne lidhje me koston, Vodafone Albania eshte e mendimit se pecaktimi i nje tarife fikse per secilen prej 3 kategorive eshte thellesisht i varur nga koston e implementimit te Z(P)B. Sic edhe e permendem me lart, keto tarifa duhet te jene te nivelit minimal pasi implementimi i kodit te ZB ka kosto te uleta ngaqe nuk kerkon investime as ne nivel hardëare (pajisje) dhe as ne nivel softëare (programe) por mbart vetem kosto te llojit: sherbime profesionale ( konfigurime, programime, etj). Ndaj dhe Vodafone Albania kerkon qe tarifa qe do te vendoset duhet te jete reale, e orientuar ne kosto dhe sipas niveleve te rajonit. Persa i perket shifrave konkrete, Vodafone gjykon se procesi eshte ne nje faze te hershme e te pavleresuar, ndaj nuk jemi ne gjendje te japim ndonje propozim konkret ne lidhje me keto kosto.

Nga na tjetër është shumë rëndësishme të sqarohet se si do të funksionojë tarifa për PB, pasi parapagimi i saj, në formën e rekomanduar le vend për abuzim nga abonente jo-korrekte, ndaj

operatorët duhet të organizojnë sa më shpejt një takim me AKEP ku të diskutohen zgjidhjet me të mira të mundshme qofte në nivel transparence e luajtshmëri por edhe implementimi teknik.

### **Plus Communication:**

Sugjeron se operator i parazgjedhur në rastet e PB me shmangie nuk duhet të paguajë tarife fikse për programim centrali apo për pajtimtar.

### **Qëndrimi i AKEP:**

*Në lidhje me këtë çështje AKEP ka bërë sqarimin në dokumentin final se këto tarifa dhe niveli i tyre do të jenë objekt i shqyrtimit dhe miratimit nga AKEP pas propozimit të Albtelecom. Duhet theksuar se asnjë prej palëve të interesuara nuk ka bërë propozime konkrete për nivele të këtyre tarifave.*

**Pyetje 5: Cfare mendoje palet e interesuara ne lidhje me parashikimet e draft-rregullores per Z(P)B ne lidhje me mbrojtjen e konsumatreve? A jane ato te majftueshme? Cilat jane propozimet tuaja per permiresimin e tyre dhe/ose kuadrit mbrojtës te konsumatorit per Z(P)B?**

Vodafone Albania dhe Albtelecom nuk kanë komente në këto pike.

### **AMC:**

Ky dokument parashikon disa pika që kanë të bëjnë me informimin e klientit në lidhje me kontratën tip të ofruesit me pajtimtarin, tarifën që duhet të kryejë abonenti, lista dhe destinacionet për kryerjen e thirrjeve të ndryshme dhe kodet perkates.

Në mendojmë që shërbimi i zgjedhjes së bartesit, së bashku me iniciativën tjetër (psh. Number Portability) mund të shkaktojë konfuzion tek abonentët.

Cdo operator që kërkon të ofrojë këto shërbime, duhet të promovojë shërbimin për të gjithë abonentët në lidhje me aspektet e ndryshme që kanë të bëjnë me funksionimin e tij, në mënyrë që ky shërbim të rezultojë sa më i qartë dhe i suksesshem. Ky fakt është i rëndësishëm pasi abonentët në vendin tonë nuk kanë pasur eksperiencë për aksesin në këto shërbime.

Për këto qëllime, ne sugjerojmë që do të ishte e nevojshme nga ana e AKEP të përgatiste një dokument për konsultim publik në lidhje me procedurat perkatese për edukimin e klienteve në përdorimin e këtij shërbimi dhe t'i kërkojë operatorit inkumbent që ta bëjë të disponueshem këtë dokument për abonentët e tij si dhe nga operatorët e tjerë që do të ofrojnë shërbimin e bartesit të thirrjeve kundrejt cdo abonenti të ri që do të përdorë këto shërbime (të dërgohet së bashku me faturën e parë për përdorimin e këtij shërbimi nga ana e klientit).

## **Plus Communication:**

Sugjeron se operatori ofruet i aksesit duhet te beje pershkrim te hollesishem, jo vetem te tarifave por edhe te sherbimit, i cili duhet te publikohet ne internet. Per sa i perket informimit te perdorusit, Plus sugjeron informim me leter shpjeguese pajtimtarit te rrjetit te aksesit nga ky operator, pasi aksesit ne Internet nuk eshte shume i zhvilluar.

## **Qëndrimi i AKEP:**

*Megjithëse palët e interesuara nuk kanë dhënë propozime konkrete, përveç njoftimit nga operator i rrjetit të aksesit me letër shpjeguese (e cila nuk duket se është praktike), AKEP ka bërë një sërë rregullimesh në rregullore për qartësimin e procedurave midis operatorëve dhe marrëdhëniet me pajtimtarin, të cilat synojnë kryesisht shmangien e praktikave abuzive, pra dhe mbrojtje më të mirë të konsumatorit.*

**Pyetje 6: Cilat jane komentet tuaja ne lidhje me alokimin e numeracionit per bartesit thirrjeve?**

## **AMC:**

Ne lidhje me alokimin e numeracionit per bartesit e thirrjeve, dokumenti parashikon qe cdo operatori qe sherben si bartes per thirrjet t'i caktohet nje kod ne formatin 10xx, duke zgjedhur vlerat per xx ne formularin e aplikimit. Ne mendojme qe nje kod me 4 shifra (sipas formatit te mesiperem) eshte i nevojshem vetem nese AKEP parashikon qe mund te kete nje numer te madh operatoresh qe do te ofrojne sherbimin per zgjedhjen e bartesit. Duke pasur parasysh kushtet aktuale te tregut te telefonise dhe dimensionet e tij ne Shqiperi, numrin e operatoreve qe jane active dhe qe do te jene te afte qe te aplikojne CS/CPS, ne mendojme qe ky nuk eshte rasti per t'u aplikuar ne vendin tone.

AKEP duhet te marre ne konsiderate mundesine e amendimit te numeracionit per t'u alokuar ne menyre qe kodet e disponueshme per bartesin e thirrjeve te jene me te shkurter (nje, dy ose me tre shifra).

## **Qëndrimi i AKEP:**

*AKEP sqaron se prefiksi për zgjedhjen e bartësit dhe formati i tij është pjesë e planit kombëtar të numeracionit, dhe formati i propozuar nga AMC do të ishte në kundërshtim me këtë Plan.*

**Pyetje 7: Cilat jane komentet tuaja ne lidhje me draft rregullore per Z(P)B? Komentet jane te mirepritura per cdo percaktim te draft rregullores.**

Komentet e paleve te interesuara per rregullore jane dhene për shume ceshtje te saj si:

- Kushtet qe duhet te vendosen ndaj operatoreve qe marrin kod dhe do operojne si bartes të thirrjeve.

Pothuajse te gjitha palet e interesuara jane shprehur per vendsosjen e detyrimeve per bartesit e thirrjeve qe ata te realizojne detyrimet ligjore te lidhura me CLI, faturimin, cilesine e sherbimeve, pergjimin e ligjshem, kodet e sinjalizimit kombetar dhe nderkombetar. Njekohesisht disa komente lidhen me saktesime ne terminologjine dhe kushtin qe nje bartes i thirrjeve duhet te jete operator rrjeti publik.

- Procedura qe ndiqen per PB dhe afatet e implementimit nga operator i rrjetit te aksesit duke kerkuar shkurtim te fatit 10 ditor si dhe qartesime te procedurave;
- Marredheniet kontraktuale midis bartesit te zgjedhur ne fillim te cdo thirrje dhe pajtimtarit duke kerkuar qe te kete percaktime qe te kete kontrate si edhe PB, madje edhe garanci financiare nga pajtimtari
- Publikimi i informacionit per bartesit e thirrjeve nga operator i rrjetit te aksesit;
- Saktesime per paketat tarifore te vecanta si dhe per detyrimet e pajtimtarit

### **Qëndrimi i AKEP:**

*AKEP ka marrë në konsideratë komentet e palëve te interesuara duke bere një sërë ndryshimesh në Rregullore si:*

- *Saktësime dhe detyrime për operatorët e rrjeteve publike që do pajisen me prefiksin për zgjedhjen e bartësit, duke përfshirë detyrime në formularin e aplikimit i dhene si Aneks 4 i Rregullores;*
- *Saktësime per proceduren e PB dhe shkurtim të afatit të aktivizimit të PB;*
- *Nevojën për kontratë me pajtimtarin për ZB në fillim të cdo thirrje, duke përfshirë të njëjtat kushte si PB;*
- *Janë bërë saktësime dhe dhënë formularë për aktivizimin, anulimin, dhe ndryshimin e PB si anekse të rregullores (Aneks 1-3).*
- *Kushte për anulimin kodit në rastet e praktikave të pandershme (slamming) nga bartësi i thirrjeve.*



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

## **RREGULLORE**

**Nr. 23 datë 29.06.2011**

**Për**

**Zgjedhjen e Bartësit**

**dhe Parazgjedhjen e Bartësit**



## NENI 1 OBJEKTI

Kjo rregullore përcakton procedurat për zbatimin e detyrimit të përcaktuar në nenin 43 të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (në vijim Ligji 9918) për t’u mundësuar pajtimtarëve të një rrjeti telefonik publik të aksesojnë shërbimet telefonike publike të disponueshme të operatorëve të tjerë të interkonektuar me të, nëpërmjet zgjedhjes dhe/ose parazgjedhjes së bartësit.

## NENI 2 PËRKUFIZIME DHE SHKURTIME

Përveç termave të përdorur në Ligjin 9918, disa terma të referuar në këtë rregullore do të kenë kuptimet e mëposhtme:

a)	<b>Z(P)B:</b> Zgjedhja dhe/ose parazgjedhja e bartësit.
b)	<b>ZB:</b> Zgjedhja e bartësit në fillim të thirrjes.
c)	<b>PB:</b> Parazgjedhja e bartësit.
d)	<b>Operator i rrjetit të aksesit:</b> nënkupton një operator rrjeti publik telefonik, i cili ofron pajtimtarit akses në rrjetin publik telefonik, dhe ndaj të cilit i është vendosur detyrimi për të mundësuar pajtimtarëve të rrjetit të tij aksesin në shërbimet e çdo ofruesi të rrjeteve dhe shërbimeve telefonike të disponueshme për publikun, të interkonektuar me të, nëpërmjet zgjedhjes dhe/ose parazgjedhjes së bartësit.
e)	<b>Bartës i thirrjeve me Z(P)B:</b> është një operator i zgjedhur dhe/ose parazgjedhur.
f)	<b>Operator i Zgjedhur:</b> nënkupton një operator të rrjeteve të komunikimeve publike i interkonektuar me Operatorin e Rrjetit të Aksesit i cili ofron shërbime publike telefonike dhe zgjidhet nga pajtimtari i Operatorit të rrjetit të aksesit, duke përdorur Prefiksin e zgjedhjes së bartësit në fillim të thirrjes telefonike.
g)	<b>Operator i Parazgjedhur:</b> nënkupton një operator të rrjeteve të komunikimeve publike i interkonektuar me Operatorin e Rrjetit të Aksesit, i cili ofron shërbime telefonike publike dhe që pajtimtari i Operatorit të Rrjetit të Aksesit e ka deklaruar atë si ofrues të disa shërbimeve publike telefonike, në bazë të një kontrate të nënshkruar më parë midis pajtimtarit dhe këtij operatori.
h)	<b>Zgjedhje e Bartësit në fillim të thirrjes:</b> nënkupton procedurën me të cilën pajtimtari i Operatorit të Rrjetit të Aksesit, mund të kryejë zgjedhjen e bartësit në fillim të thirrjes duke formuar prefiksin e bartësit të zgjedhur përpara numrit telefonik që thirret.
i)	<b>Parazgjedhja e Bartësit:</b> nënkupton një procedurë të programuar më parë, për t’i bërë të mundur pajtimtarit të Operatorit të Rrjetit të Aksesit, të lidhet me bartësin e parazgjedhur, me të cilin ka nënshkruar më parë një kontratë për ofrimin e disa

	shërbimeve telefonike, pa i hequr mundësinë pajtimatrit të zgjedhjes së bartësit në fillim të thirrjes.
j)	<b>Prefiksi i Bartësit të Zgjedhur/parazgjedhur:</b> nënkupton një numër me katër shifra në formatin “10xx” ku “xx” është prefiksi i operatorit të zgjedhur i caktuar nga AKEP në përputhje me Planin e Numeracionit të Republikës së Shqipërisë.
k)	<b>Thirrje Lokale:</b> nënkupton një thirrje të origjinuar nga pajtimtari i një zone gjeografike nga rrjeti i një operatori rrjeti telefonik fiks tek një pajtimtar në të njëjten zonë gjeografike pa qënë nevoja e formimit të prefiksit të zonës gjeografike të pajtimtarit të thirrur.
l)	<b>Thirrje Kombëtare:</b> nënkupton një thirrje të origjinuar nga pajtimtari i një rrjeti publik telefonik në një zonë gjeografike drejt një pajtimtari rrjeti publik telefonik fiks në një zonë tjetër gjeografike duke formuar prefiksin përkatës (kombëtar dhe kodin e kësaj zone gjeografike) përpara numrit të pajtimtarit të thirrur.
m)	<b>Thirrje ndërkombëtare:</b> nënkupton një thirrje të origjinuar nga pajtimtari i një rrjeti publik telefonik tek një pajtimtar në një shtet tjetër duke formuar një prefiks ndërkombëtar dhe kodin e shtetit përpara numrit kombëtar të pajtimtarit të thirrur, i lidhur në një rrjet publik fiks ose mobil.
n)	<b>Të gjitha thirrjet:</b> nënkupton të gjitha kategorite e thirrjeve përveç thirrjeve drejt numrave të emergjencës.
o)	<b>Paketë e veçante tarifore:</b> paketë tarifore që përfiton pajtimtari nga ofruesi i aksesit në linjën telefonike dhe e përjashtuar (me miratim të AKEP) nga detyrimi për mundësimin e Z(P)B.
p)	PABX: Private Automatic Branch eXchange

### NENI 3 KUSHTET E PËRGJITHSHME TË ZGJEDHJES DHE PARAZGJEDHJES SË BARTËSIT

1. Operatori i rrjetit të aksesit do të ofrojë zgjedhjen e bartësit dhe/ose parazgjedhjen e bartësit për ata operatorë të cilet plotësojnë tre kushtet e mëposhtme:
  - (a) Janë regjistruar zyrtarisht në *Rregjistrin e Sipërmarrësve për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike sipas regjimit të autorizimit të përgjithshëm*, për ofrimin e rrjeteve publike të telefonisë.
  - (b) Kanë nënshkruar një marrveshje interkoneksioni me të, dhe
  - (c) Janë pajisur me prefiks të bartësit të thirrjeve sipas procedurave përkatëse të AKEP.
2. Operatori i rrjetit të aksesit rrugëzon thirrjet e pajtimtarit të tij në drejtim të operatorit të zgjedhur dhe/ose parazgjedhur, i cili përveç detyrimeve në pikën 1 të këtij neni, duhet të realizojë të gjitha thirrjet lokale, kombëtare dhe/ose të gjitha thirrjet ndërkombëtare, në

përputhje me marrëveshjen e interkoneksionit të nënshkruar midis tij dhe operatorit ofrues të aksesit për Z(P)B.

3. Operatori i rrjetit të Aksesit paraqet në ofertën referencë të interkoneksionit të gjitha tarifat e aplikueshme për operatorët e zgjedhur dhe parazgjedhur të thirrjeve dhe procedurat përkatëse për implementimin e shërbimeve.
4. Operatori i rrjetit të aksesit nuk do të tarifojë pajtimtarin e rrjetit të tij për thirrjet e kryera me Z(P)B.
5. Në rastin e parazgjedhjes së bartësit, pajtimtari i operatorit të rrjetit të aksesit mund të lidhë një kontratë me një operator të parazgjedhur për një, disa apo të gjitha kategoritë e thirrjeve sipas alternativave të mëposhtme:
  - a. Thirrje ndërkombëtare
  - b. Thirrje kombëtare
  - c. Thirrje kombëtare dhe ndërkombëtare
  - d. Të gjitha thirrjet

Pajtimtari ka të drejtë të parazgjedhë një operator për alternativën 'a' dhe një operator tjetër për 'b', ose të njëjtin operator për 'a' dhe 'b' (d.m.th alternativën 'c'). Për alternativën 'd' pajtimtari mund të parazgjedhë vetëm një operator dhe nuk mund të parazgjedhë operatorë të tjerë për alternativat e tjera të thirrjeve. Në secilin prej rasteve të mësipërme pajtimtari ka të drejtë të përdorë edhe zgjedhjen e bartësit në fillim të thirrjes duke formuar prefiksin përkatës të një operatori të zgjedhur. Disponibiliteti i alternativave të mësipërme 'a-d' është në varësi të detyrimeve të vendosura nga AKEP ndaj operatorit të rrjetit të aksesit për mundësimin e Z(P)B.

6. Operatori i rrjetit të aksesit ka detyrimin të ofrojë mundësinë e Z(P)B për të gjithë pajtimtarët që përdorin paketat tarifore standarte dhe nuk ka detyrim të aplikojë zgjedhjen e bartësit dhe/ose parazgjedhjen e bartësit për ata pajtimtarë që kanë nënshkruar kontratë pajtimi me të me paketa të veçanta tarifore (në këto raste, për të përfituar mundësinë e përdorimit të Z(P)B, pajtimtari duhet të kalojë në paketë tarifore standarte), si dhe nga telefonat publike me pagesë. Për numrat e telefonit të lidhur me PABX, PB është e mundur për të gjithë numrat dhe nuk mund të kryhet për numra të veçantë të lidhur me BRI ose PRI PABX.

#### **NENI 4**

#### **PROCESI PËR ZGJEDHJEN E BARTËSIT NË FILLIM TË THIRRJES**

1. Procesi i zgjedhjes së bartësit në fillim të çdo thirrje fillon nëpërmjet nënshkrimit të një një kontrate midis pajtimtarit dhe operatorit të zgjedhur, sipas përcaktimeve në nenin 6 të kësaj Rregulloreje. Nënshkrimi i kontratës nga pajtimtari do të thotë që:
  - (a) Pajtimtari pranon kushtet e kontratës së lidhur me operatorin e zgjedhur;
  - (b) Kontrata e Pajtimtarit e nënshkruar me operatorin i rrjetit të aksesit ose me një operator tjetër të parazgjedhur, nuk do të jetë më e vlefshme për thirrjet e kryera duke formuar prefiksin e operatorit të zgjedhur.

2. Operatori i zgjedhur është përgjegjës për faturimin e thirrjeve të pajtimtarit të realizuara me prefiksin e tij dhe mbledhjen e pagesave të pajtimtarit për këto thirrje. Në këtë proces operatori i zgjedhur mund të bashkepunojë me operatorin e rrjetit të aksesit në terma komerciale. Mënyra e pagesës së detyrimeve nga pajtimtari përfshihet në kontratën e nënshkruar midis pajtimtarit dhe operatorit të parazgjedhur.
3. Operatori i rrjetit aksesit lejon përdorimin e shërbimit të zgjedhjes së bartësit në fillim të thirrjes, në të gjitha rastet kur pajtimtari formon prefiksin e operatorit të zgjedhur, përveç rasteve kur pajtimtari ka nënshkruar një kontratë me operatorin e rrjetit të aksesit me paketë të veçantë tarifore të përjashtuar nga detyrimi për mundësimin e Z(P)B.
4. Kur pajtimtari formon prefiksin e operatorit të zgjedhur, operatori i rrjetit të aksesit rrugëzon thirrjen drejt operatorit që zotëron prefiksin, përveç përjashtimit të cituar në pikën 3 të këtij neni, dhe më pas është përgjegjësia e operatorit që zotëron prefiksin të rrugëzojë ose jo thirrjen;
  - a. në rast se operatori i zgjedhur ka kontratë me pajtimtarin, Operatori i zgjedhur rrugëzon thirrjen në destinacion
  - b. në rast se operatori i zgjedhur nuk ka kontratë me pajtimtarin, operatori i zgjedhur refuzon thirrjen. Në rast të pranimit të thirrjes për rrugëzim, operatori i zgjedhur paguan detyrimin përkatës ndaj operatorit të rrjetit të aksesit.

## **NENI 5 PROCEDURA E PARAZGJEDHJES SË BARTËSIT**

1. Procedura e parazgjedhjes së bartësit fillon nëpërmjet nënshkrimit të një deklaratë sipas Formularit të Aktivizimit të Parazgjedhjes së Bartësit, të dhënë në Aneks 1 të kësaj Rregulloreje. Formulari nënshkruhet nga pajtimtari në dy ekzemplarë origjinale, duke përcaktuar kategoritë e thirrjeve sipas alternativave të përcaktuara në nenin 3, pika 5 të kësaj Rregulloreje, që pajtimtari dëshiron të përfitojë nga operatori i parazgjedhur. Në këtë fazë kryhet dhe nënshkrimi i një kontrate midis pajtimtarit dhe operatorit të parazgjedhur. Kjo kontratë nuk duhet të shkaktojë pasoja juridike tek kontrata aktuale e pajtimtarit me operatorin e rrjetit të aksesit për të shmangur detyrimet që pajtimtari ka ndaj operatorit të rrjetit të aksesit për shërbimet e përfituara prej tij më parë dhe/ose që vazhdon të përfitojë. Kontrata e nënshkruar në këtë fazë duhet të ketë një përcaktim që të parashikojë hyrjen në fuqi të saj në momentin që aktivizimi i parazgjedhjes së bartësit bëhet aktiv.
2. Operatori i parazgjedhur duhet të dërgojë tek operatori i rrjetit të aksesit në rrugë elektronike me email/fax kërkesën së bashku me kopje të skanuar të deklaratës së nënshkruar nga pajtimtari.
3. Pas marrjes së kërkesës sipas pikës 2, operatori i rrjetit të aksesit duhet të dërgojë përgjigje në rrugë elektronike operatorit të parazgjedhur për kërkesën, brenda 2 (dy) ditëve pune, në një prej alternativave të mëposhtme:
  - (a) Konfirmim pozitiv për aktivizimin e PB;

(b) Përgjigje negative duke shpjeguar arsyet e refuzimit sipas pikës 10, të këtij neni.

4. Në rast të konfirmimit pozitiv sipas pikës 3/a të këtij neni, Operatori i parazgjedhur duhet të dërgojë tek operatori i rrjetit të aksesit kërkesën në formë shkresore, së bashku me njërin ekzemplar origjinal të Formularit të Aktivizimit të Parazgjedhjes së Bartësit të nënshkruar nga pajtimtari për parazgjedhjen e shërbimeve të ofruara nga operator i parazgjedhur.
5. Në rast të përgjigjes negative sipas pikës 3/b të këtij neni, Operatori i parazgjedhur rishikon informacionin (nëse ka nevojë për saktësime) dhe procedura rifillon përsëri nga e para, ose operatori i parazgjedhur ndërpret procesin nëse pajtimtarit nuk mund t'i ofrohet PB, duke e njoftuar pajtimtarin për arsyen e refuzimit.
6. Në rast se dokumentacioni në formë shkresore (Kërkesa dhe Formulari Aktivizimit të Parazgjedhjes së Bartësit të nënshkruar nga pajtimtari) përputhet me dokumentacionin e dërguar në rrugë elektronike, Operatori i rrjetit të aksesit duhet të implemtojë PB brenda 3 ditë pune nga marrja e kërkesës në formë shkresore në pikën 4 të këtij neni, ose në datën e kërkuar nga pajtimtari në Formularin e Aktivizimit të PB nëse kjo datë është më vonë se afati 3 ditë pune. Operatori i rrjetit të aksesit njofton brenda ditës (së marrjes së dokumentacionit në formë shkresore sipas kësaj pike) operatorin e parazgjedhur në rrugë elektronike për datën dhe orën se kur do të aktivizohet parazgjedhja e bartësit si dhe për çdo vonesë të paparashikuar dhe Operatori i parazgjedhur i përcjell pajtimtarit këtë informacion, të paktën 24 orë para aktivizimit të PB.
7. Në rast se dokumentacioni i dërguar në formë shkresore në pikën 6 të këtij neni nuk përputhet me informacionin e dërguar në rrugë elektronike, operatori i rrjetit të aksesit, brenda 1 dite pune, i dërgon në rrugë elektronike operatorit të parazgjedhur njoftimin dhe arsyen e mospërputhjes së informacionit. Operatori i parazgjedhur rishikon informacionin (nëse ka nevojë për saktësime) dhe procedura rifillon përsëri nga pika 5 e këtij neni.
8. Kërkesa e operatorit të parazgjedhur në pikën 2 të këtij neni mund të përfshijë më shumë se një numër/pajtimtar, ndërsa bashkangjitur duhet të përfshihen të gjithë formularët e nënshkruar nga pajtimtarët. Kërkesa në formë shkresore në pikën 4 të këtij neni dërgohet vetëm për numrat/pajtimtarët që kanë marrë konfirmim pozitiv.
9. Operatori i rrjetit të aksesit kryen përgatitjet e nevojshme për të bërë aktiv shërbimin e parazgjedhjes së bartësit, brenda 5 ditëve pune nga dita e marrjes së kërkesës në formë elektronike (në pikën 2 të këtij neni) deri në maksimumi 3 ditë pune nga data e marrjes së kërkesës në formë shkresore të operatorit të parazgjedhur (në pikën 4 të këtij neni).
10. Operatori i rrjetit të aksesit refuzon kërkesën për shërbimin e parazgjedhjes së bartësit nëse:
  - a) Nuk ekziston një kontratë për shërbimin publik telefonik e nënshkruar midis pajtimtarit dhe operatorit të rrjetit të aksesit;
  - b) Kërkesa e operatorit të parazgjedhur dhe/ose deklarata e pajtimtarit përmban të dhëna të pasakta si p.sh. mospërputhje e identitetit të pajtimtarit me numrin e telefonit.
    - a. Për gabimet në identitetin e pajtimtarit (emri, mbiemri) të dy palët duhet të komunikojnë (dhe me pajtimtarin nëse është e nevojshme) në rrugë elektronike për saktësimin e tyre që të mos shërbejë si arsye refuzimi.
  - c) Kërkesa është në lidhje me një pajtimtar i cili përfiton paketë të veçantë tarifore, të përjashtuar nga detyrimi për mundësimin e Z(P)B.

11. Operatori i rrjetit të aksesit do të ndërpresë ofrimin e shërbimit të parazgjedhjes së bartësit nëse:
  - a) Bartësi i parazgjedhur kërkon në formë shkresor ndërprerjen e shërbimit;
  - b) Pajtimtari bën kërkesë me shkrim për ndërprerjen e shërbimit të PB duke plotësuar Formularin e Anullimit të PB (aneks 2);
  - c) Marrëveshja e interkoneksionit midis operatorit të rrjetit të aksesit dhe operatorit të parazgjedhur ka përfunduar/ndërprerë;Operatori i rrjetit të aksesit do të njoftojë pajtimtarin për rastet e pikave (a) dhe (c) dhe operatorin e para-zgjedhur për rastin e pikës (b).
12. Operatori i rrjetit të aksesit nuk do të kufizojë numrin e operatorëve të parazgjedhur të pajtimtarit dhe do të lejojë që pajtimtari të kryejë thirrje me zgjedhje bartësi në fillim të çdo thirrje duke formuar prefiks të përkatës.
13. Parazgjedhja e bartësit të thirrjes funksionon mbi parimin “one stop shop”, që do të thotë:
  - (a) Kërkesa për parazgjedhje të bartësit nga pajtimtari kryhet tek bartësi respektiv, duke plotësuar Formularin sipas tipit në Aneks 1. Në rast se pajtimtari kontakton operatorin e rrjetit të aksesit për aktivizimin e PB, operatori i rrjetit të aksesit e adreson pajtimtarin tek operatori i parazgjedhur (d.m.th. duke e informuar se kërkesa duhet të bëhet tek ai operator);
  - (b) Kërkesa për anulimin e PB (dhe rikthim tek operatori i rrjetit të aksesit) kryhet tek operatori i rrjetit të aksesit, duke plotësuar formularin e anulimit të PB (sipas tipit në Aneks 2) dhe operatori i rrjetit të aksesit dërgon kërkesën tek operatori i parazgjedhur sipas procedurës së pikave 2-8 të këtij neni.
  - (c) Kërkesa për ndryshim të bartësit të parazgjedhur kryhet tek operatori i ri (sipas tipit të formularit në Aneks 3) dhe ky i fundit njofton operatorin e mëparshëm të parazgjedhur.
14. Secili operator duhet t'i japë operatorit tjetër (të përfshirë në procesin e parazgjedhjes së bartësit) adresat postare, e-mail, numrat e telefonit dhe fax të personave përgjegjës për parazgjedhjen e bartësit dhe shkëmbimin e informacionit të nevojshëm për procesin e parazgjedhjes së bartësit, të përshkruar në këtë Rregullore.

## **NENI 6**

### **KONTRATA MIDIS PAJTIMITARIT DHE OPERATORIT TË PARAZGJEDHUR/ZGJEDHUR**

1. Kontrata e nënshkruar midis pajtimtarit dhe operatorit të parazgjedhur, përveç elementeve të përcaktuara në nenin 99 të Ligjit 9918 do të përmbajë:
  - (a) Kategoritë e thirrjeve telefonike të përzgjedhura nga pajtimtari të grupuara sipas kategorive të përgjedhura;
  - (b) Listën e destinacioneve për të cilat pajtimtari mund të kryejë thirrje të detajuara sipas kategorive kryesore (lokale, kombëtare, ndërkombëtare) duke specifikuar destinacionet brënda secilës kategori që nuk mund të realizohen thirrjet prej tij;

- (c) Detyrimin që në rastin kur pajtimtari ka kontratë me një operator tjetër të parazgjedhur, ai duhet të njoftojë operatorin e ri të parazgjedhur për ekzistencën e kontratës me operatorin e mëparshëm të parazgjedhur.
  - (d) Detyrimin që operatori i ri i parazgjedhur të njoftojë operatorin e parazgjedhur më parë për kalimin e pajtimtarit tek operatori i parazgjedhur (ai vetë).
2. Nënshkrimi i kontratës midis pajtimtarit me operatorin e parazgjedhur do të thotë si në vijim:
- (c) Pajtimtari do të pranojë kushtet e kontratës së lidhur me operatorin e parazgjedhur;
  - (d) Kontrata e Pajtimtarit e nënshkruar me operatorin i rrjetit të aksesit ose me një operator tjetër të parazgjedhur, nuk do të jetë më e vlefshme për shërbimin e zgjedhur.
3. Nënshkrimi i kontratës midis pajtimtarit dhe operatorit të parazgjedhur nuk do të prekë detyrimet që ka pajtimtari ndaj operatorit të rrjetit të aksesit, përfshirë detyrimin për të paguar pajtimin mujor dhe tarifat e shërbimeve të tjera të ofruara nga ofruesi i rrjetit të aksesit dhe përfituara nga pajtimtari;
4. Shërbimi i parazgjedhjes apo çdo ndryshim apo tërheqje e një kontrate të vlefshme midis pajtimtarit dhe operatorit të parazgjedhur do të hyjë në fuqi në ditën kur bëhet efektiv shërbimi i parazgjedhur ose anulimi i tij.
5. Termat e përgjithme të kontratës (kontrata tip) midis operatorit të parazgjedhur dhe pajtimtarit hartohen nga operatori i parazgjedhur dhe miratohen nga AKEP, dhe shërben si bazë për lidhjen e kontratës midis pajtimtarit dhe operatorit të parazgjedhur.
6. Operatori i parazgjedhur ka detyrimin të publikojë në faqen e internetit të tij (e cila duhet të jetë me domain '.al') termat e përgjithshme të kontratës me pajtimtarin së bashku me tarifat e thirrjeve telefonike të ofruara prej tij dhe mënyrën e tarifimit.
7. Përcaktimet e mësipërme për kontratën midis pajtimtarit dhe operatorit të parazgjedhur për bartjen e thirrjeve me parazgjedhje (PB) aplikohen edhe për kontratën midis pajtimtarit dhe operatorit të zgjedhur për bartjen e thirrjeve në fillim të çdo thirrje (ZB).

## **NENI 7**

### **INFORMIMI I PAJTIMTARËVE PËR Z(P)B**

1. Operatori i rrjetit të aksesit do të publikojë në faqen e tij të internetit në mënyrë transparente informacionin e mëposhtëm për operatorët që mund të zgjidhen në fillim të thirrjes dhe me parazgjedhje, me të cilët ka lidhur marrveshje interkoneksioni, duke i renditur sipas rendit alfabetik:
- (a) Emri, adresa dhe numri i telefonit të shërbimit të kujdesit ndaj klientit, e operatorit të zgjedhur dhe/ose operatorit të parazgjedhur.
  - (b) Linku për në Faqen e internetit e operatorit të zgjedhur dhe/ose operatorit të parazgjedhur.

2. Operatori i parazgjedhur/zgjedhur do t'i dërgojë të dhënat e cituara në pikën 1 të këtij neni, operatorit të rrjetit të aksesit. Operatori i parazgjedhur/zgjedhur ofron këto të dhëna pa pagesë dhe duhet të njoftojë operatorin e rrjetit të aksesit për çdo ndryshim të tyre si dhe në rast se evidenton gabime në publikimin e tyre.
3. Në rastin e zgjedhjes së bartesit për çdo thirrje, operatori i zgjedhur është i detyruar të informojë pajtimtarin në mënyrën e përcaktuar në kushtet e përgjithshme të kontratës së pajtimtarit që operatori i rrjetit të aksesit dhe operatori i zgjedhur nuk kanë arritur marrëveshje interkoneksioni për destinacione të ndryshme thirrjesh telefonike.
4. Operatori i parazgjedhur/zgjedhur ka detyrimin të publikojë në faqen e internetit të tij:
  - (a) termat e përgjithshme të kontratës me pajtimtarin së bashku me tarifat e thirrjeve telefonike të ofruara prej tij dhe mënyrën e tarifimit.
  - (b) Listën e destinacioneve për të cilat pajtimtari mund të kryejë thirrje të detajuara sipas kategorive kryesore (lokale, kombëtare, ndërkombëtare) duke specifikuar destinacionet brenda secilës kategori që nuk mund të realizohen thirrjet prej tij;

## **NENI 8**

### **BASHKËPUNIMI MIDIS OPERATORËVE PËR OFRIMIN E Z(P)B**

1. Operatori i rrjetit të aksesit dhe operatori i zgjedhur dhe/ose parazgjedhur, do të përcaktojnë kushtet e bashkëpunimit përsa i përket shërbimit të zgjedhjes së bartesit dhe/ose parazgjedhjes së bartesit, në marrëveshjen e interkoneksionit të nënshkruar midis tyre.
2. Operatori i rrjetit të aksesit dhe operatori i zgjedhur dhe/ose parazgjedhur janë të detyruar të bëjnë të mundur identifikimin e numrave thirres ose numrave të thirrur. Në rastin kur pajtimtari kërkon parandalimin e shfaqjes së numrit që e thërret ose numrit të thirrur, kjo duhet të implementohet në përputhje me rregullimet për mbrojtjen e të dhënave personale për shërbimet e komunikimeve publike.
3. Nëse nuk ka ndonjë marrëveshje për ndarjen e detyrimeve midis operatorit i rrjetit të aksesit dhe operatorit të zgjedhur dhe/ose parazgjedhur, në rastin e ofrimit të shërbimeve për pajtimtarin nga operatori i zgjedhur dhe/ose parazgjedhur nën nivelin e treguesve të cilësisë së përcaktuar nga AKEP, ose në rastin e mos trajtimit të ankesave të pajtimtarëve, përgjegjësitë do të përballohen nga operatori i zgjedhur dhe/ose parazgjedhur.
4. Operatori bartës i thirrjeve duhet të plotësojë të gjitha detyrimet e parashikuara në kuadrin ligjor dhe rregullator për ofrimin e shërbimeve të komunikimit publik si p.sh. CLI, ruajtja e të dhënave, përgjimi i ligjshëm i komunikimeve.

## **NENI 9**

### **FATURIMI**

1. Operatori i zgjedhur dhe operatori i parazgjedhur janë përgjegjës për faturimin e thirrjeve telefonike të kryera nga pajtimtari përkatësisht me zgjedhje bartësi në fillim të thirrjes dhe me parazgjedhje bartësi.



2. Operatori i rrjetit të aksesit dhe operatori i zgjedhur dhe/ose parazgjedhur mund të negociojnë dhe bashkëpunojnë me njëri tjetrin për proceset e lëshimit/dërgimit dhe pagimit të faturave nga pajtimtari.

## **NENI 10**

### **APLIKIMI PËR PREFIKSIN E ZGJEDHJES SË BARTËSIT**

#### **1. E drejta për të aplikuar:**

- a) Çdo sipërmarres që është regjistruar zyrtarisht në *Regjistrin e sipërmarrësve që kanë njoftuar për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të Komunikimeve elektronike publike sipas regjimit të autorizimit të përgjithshëm*, dhe që plotëson kushtet e mëposhtme ka të drejtë të aplikojë për pajisjen me prefiks për zgjedhjen e bartësit:
  1. Është i regjistruar për të ofruar rrjet publik telefonik dhe shërbime publike telefonike në RSH
  2. Zotëron faqe interneti aktive nën domain “.al”:
  3. Është i pajisur me Kod Pike Sinjalizimi Kombëtare (NSPC)/Ndërkombëtare (ISPC) :
  4. Zotëron kapacitete teknike dhe menaxhuese për zbatimin e kërkesave të kuadrit ligjor dhe rregullator për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve publike telefonike, përfshirë midis të tjerave:
    - faturimin e detajuar të pajtimtarit;*
    - realizimin e treguesve të cilësisë sipas Rregullores së AKEP “Për treguesit e Cilësisë”*
    - zbatimin e rregullave për portabilitetin e numrit sipas Rregullave të përcaktuara nga AKEP;*
    - zbatimin e standarteve dhe rekomandimeve të ITU, IEEE, RIPE NCC, etj;*
    - garantimin e CLI transparent, dhe kushteve për paraqitjen e CLI;*
    - kërkesat të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”;*
    - kërkesat ligjore në lidhje me përgjimin e ligjshëm për të gjitha thirrjet që do të kalojnë në sistem.*
- b) Çdo sipërmarrësi të autorizuar mund t’i caktohet vetëm një prefiks për zgjedhjen e bartësit. Të gjithë aplikantët të cilët mund të aplikojnë kanë akses të njëjtë në prefikset e disponueshëm për zgjedhjen e bartësit.

## **2. Zgjedhja e prefiksit nga aplikantët:**

- a) Aplikantët e kualifikuar kanë mundësinë të përcaktojnë preferencat e tyre nga prefikset e disponueshem në formatin "10xx" duke zgjedhur vlerat për xx.. Preferencat paraqiten në Formularin e Aplikimit.
- b) Aplikimet vlerësohen nga AKEP:
  - i. prefikset 10x0 nuk janë në dispozicion për tu caktuar;
  - ii. prefikset caktohen me parimin "First come first served"
  - iii. Në rast të kërkesave të njëkohëshme për të njëjtin prefiks, hidhet short në prani të aplikantëve.
- c) Prefikset për Zgjedhjen e Bartësit do të përdoren për të siguruar akses në bartësit e zgjedhur.

## **3. Anullimi i prefiksit të caktuar:**

Prefiksi për Zgjedhjen e Bartësit mund të anulohet nga AKEP sipas përcaktimeve në Ligjin 9918 dhe rregullave të përcaktuara në Nenin 29 të "Rregullore për Caktimin dhe Përdorimin e Numrave dhe Serive Numerike", miratuar me Vendimin Nr.932, datë 11.08.2009 të Këshillit Drejtues të AKEP, si dhe në rastet e mëposhtme.

- a. Operatori deklaron falimentimin;
- b. Operatori të cilit i është caktuar prefiksi ka iniciur procedurë për PB pa pëlqimin e pajtimitarit;
- c. Anullimi është me interes publik.

## **4. Publikimi i Prefikseve për Zgjedhjen e Bartësit të caktuar**

AKEP publikon të dhëna për Prefikset për Zgjedhjen e Bartësit të caktuar dhe aplikantët të cilëve u është caktuar Prefiksi për Zgjedhjen e Bartësit, në faqen e tij të Internetit.

## **5. Formulari i aplikimit**

*Sipërmarrësit që aplikojnë për Prefikset për Zgjedhjen e Bartësit në përputhje me këtë dokument duhet të plotësojnë Formularin e Aplikimit të përcaktuar në Aneks 4 të kesaj rregulloreje.*

### **NENI 11 HYRJA NË FUQI**

Kjo rregullore hyn në fuqi në datën e miratimit me Vendim të KD të AKEP.

## FORMULARI PËR AKTIVIZIMIN E PARAZGJEDHJES SË BARTËSIT

TË DHËNAT E PAJTIMTARIT	
Emri , Mbiemri (për individët):  Emri i shoqërisë (për persona fizik/juridik):  Emri i Institucionit, organizatës, shoqatës, etj	
Adresa Postare:	
Emrin e personit të autorizuar: (Vetëm për persona fizik/juridik, institucione, organizata, shoqata, etj)	
Numri i regjistrimit : (Vetëm për persona fizik/juridik, institucione, organizata, shoqata, etj)	
Bashkangjitur:	<b>Individ:</b> <input type="checkbox"/> <i>Kopje Pasaporte</i> <input type="checkbox"/> <i>Kopje e Kartës së Identitetit</i>  <b>Person fizik/juridik</b> <input type="checkbox"/> <i>Ekstrakt nga QKR</i>  <b>Institucione, Organizata, Shoqata, etj</b> <input type="checkbox"/> <i>Shkresë nga titullari me firmë dhe vulë.</i> <input type="checkbox"/> <i>Ekstrakt nga QKR</i> <input type="checkbox"/> <i>Tjetër</i>
<b>Kontakte:</b>  Numër Telefoni Fax e-mail	
ADRESA E NUMRIT TË TELEFONIT	
Kodi Postar: <i>(jo i detyrueshëm)</i>	
<i>Qyteti/Komuna/Fshati</i>	
<i>Rruga:</i>	
TË DHËNA TË TJERA	
<i>Numri apo numrat e pajtimtarit:</i>	

<i>Emri i Operatorit të parazgjedhur:</i>	
<i>Adresa e operatorit të parazgjedhur:</i>	
<i>Emri i Operatorit Ofrues të Aksesit në linjën telefonike:</i>	
<i>Adresa e operatorit të aksesit në linjën telefonike:</i>	
<i>Lloji i thirrjeve për të cilat autorizohet operatori i parazgjedhur:</i>	<input type="checkbox"/> <b>Kombëtare</b> <input type="checkbox"/> <b>Ndërkombëtare</b> <input type="checkbox"/> <b>Kombëtare dhe Ndërkombëtare</b> <input type="checkbox"/> <b>Të gjitha thirrjet</b>
<i>Data e preferuar/kërkuar për aktivizim PB</i>	____.____.20____

Nëpërmjet nënshkrimit të këtij formulari deklaroj si më poshtë:

1. Aktualisht përdor shërbimin telefonik për numrin/numrat e sipërsënuar të telefonit në rrjetin e operatorit të rrjetit të aksesit të linjës telefonike (*vendos emrin e operatorit të rrjetit të aksesit*) dhe dëshiroj që thirrjet e përcaktuara më sipër të barten nga operatori i parazgjedhur (*vendos emrin operatorit të parazgjedhur*).
2. Autorizoj operatorin e parazgjedhur (*vendos emrin operatorit të parazgjedhur*) dhe operatorin e rrjetit të aksesit (*vendos emrin e operatorit të rrjetit të aksesit*) të shkëmbejnë informacionin personal, që është i nevojshëm për të aktivizuar PB.
3. Autorizoj operatorin e parazgjedhur, (*vendos emrin operatorit të parazgjedhur*) që në emrin tim, ti dërgojë kërkesën time operatorit të aksesit të linjës telefonike (*vendos emrin e operatorit të rrjetit të aksesit*) për aktivizimin e PB sipas zgjedhjeve në formularin e nënshkruar.

Pajtimtari:

\_\_\_\_\_  
(Vendi dhe data)

\_\_\_\_\_  
(Nënshkrimi)

Operatori i Parazgjedhur:

Firma dhe Vula Zyrtare e Operatorit



## FORMULARI PËR ANULLIMIN E PARAZGJEDHJES SË BARTËSIT

TË DHËNAT E PAJTIMTARIT	
Emri , Mbiemri (për individët):  Emri i shoqërisë (për persona fizik/juridik):  Emri i Institucionit, organizatës, shoqatës, etj	
Adresa Postare:	
Emrin e personit të autorizuar: (Vetëm për persona fizik/juridik, institucione, organizata, shoqata, etj)	
Numri i regjistrimit : (Vetëm për persona fizik/juridik, institucione, organizata, shoqata, etj)	
Bashkangjitur:	<p><b>Individ:</b></p> <input type="checkbox"/> <i>Kopje Pasaporte</i> <input type="checkbox"/> <i>Kopje e Kartës së Identitetit</i> <p><b>Person fizik/juridik</b></p> <input type="checkbox"/> <i>Ekstrakt nga QKR</i> <p><b>Institucione, Organizata, Shoqata, etj</b></p> <input type="checkbox"/> <i>Shkresë nga titullari me firme dhe vulë.</i> <input type="checkbox"/> <i>Ekstrakt nga QKR</i> <input type="checkbox"/> <i>Tjetër</i>
<b>Kontakte:</b>  Numër Telefoni Fax e-mail	
ADRESA E NUMRIT TË TELEFONIT	
Kodi Postar: <i>(jo i detyrueshëm)</i>	
<i>Qyteti/Komuna/Fshati</i>	
<i>Rruga:</i>	
TË DHËNA TË TJERA	
<i>Numri apo numrat e pajtimtarit:</i>	

<i>Emri i Operatorit të parazgjedhur:</i>	
<i>Adresa e operatorit të parazgjedhur:</i>	
<i>Emri i Operatorit Ofrues të Aksesit në linjën telefonike:</i>	
<i>Adresa e operatorit të aksesit në linjën telefonike:</i>	
<i>Lloji i thirrjeve për të cilat autorizohet anulimi i parazgjedhjes së bartësit:</i>	<input type="checkbox"/> <b>Kombëtare</b> <input type="checkbox"/> <b>Ndërkombëtare</b> <input type="checkbox"/> <b>Kombëtare dhe Ndërkombëtare</b> <input type="checkbox"/> <b>Të gjitha thirrjet</b>
<i>Data e preferuar/kërkuar për anulimin e PB</i>	____.____.20____

Nëpërmjet nënshkrimit të këtij formulari deklaroj si më poshtë:

1. përdor shërbimin telefonik për numrin/numrat e sipërsënuar të telefonit në rrjetin e operatorit të rrjetit të aksesit të linjës telefonike (*vendos emrin e operatorit të rrjetit të aksesit*) dhe dëshiroj që të anulohet parazgjedhja e bartësit për thirrjet e përcaktuara më sipër, që aktualisht barten nga operatori i parazgjedhur (*vendos emrin e operatorit të parazgjedhur*),
2. Autorizoj operatorin e parazgjedhur (*vendos emrin e operatorit të parazgjedhur*) dhe operatorin e rrjetit të aksesit (*vendos emrin e operatorit të rrjetit të aksesit*) të shkëmbejnë informacionin personal, që është i nevojshëm për të anuluar PB.
3. Autorizoj operatorin e rrjetit të aksesit të linjës telefonike (*vendos emrin e operatorit të rrjetit të aksesit*) që në emrin tim, ti dërgojë operatorit të parazgjedhur (*vendos emrin e operatorit të parazgjedhur*) kërkesën time për anulimin e PB sipas zgjedhjeve në formularin e nënshkruar.

Pajtimtari:

\_\_\_\_\_  
(Vendi dhe data)

\_\_\_\_\_  
(Nënshkrimi)

Operatori i Rrjetit të Aksesit:

Firma dhe Vula Zyrtare e Operatorit

**FORMULARI PËR  
KALIMIN NGA NJË BARTËS I PARAZGJEDHUR TEK NJË TJETËR BARTËS I  
PARAZGJEDHUR**

<b>TË DHËNAT E PAJTIMTARIT</b>	
Emri , Mbiemri (për individët):  Emri i shoqërisë (për persona fizik/juridik):  Emri i Institucionit, organizatës, shoqatës, etj	
Adresa Postare:	
Emrin e personit të autorizuar: (Vetëm për persona fizik/juridik, institucione, organizata, shoqata, etj)	
Numri i regjistrimit : (Vetëm për persona fizik/juridik, institucione, organizata, shoqata, etj)	
Bashkangjitur:	<b>Individ:</b> <input type="checkbox"/> Kopje Pasaporte <input type="checkbox"/> Kopje e Kartës së Identitetit  <b>Person fizik/juridik</b> <input type="checkbox"/> Ekstrakt nga QKR  <b>Institucione, Organizata, Shoqata, etj</b> <input type="checkbox"/> Shkresë nga titullari me firme dhe vulë. <input type="checkbox"/> Ekstrakt nga QKR <input type="checkbox"/> Tjetër
<b>Kontakte:</b>  Numër Telefoni Fax e-mail	
<b>ADRESA E NUMRIT TË TELEFONIT</b>	
Kodi Postar: (jo i detyrueshëm)	
Qyteti/Komuna/Fshati	
Rruga:	
<b>TË DHËNA TË TJERA</b>	
Numri apo numrat e pajtimtarit:	
Emri i Operatorit aktual të parazgjedhur:	



<i>Adresa e operatorit aktual të parazgjedhur:</i>	
<i>Emri i Operatorit të ri të parazgjedhur:</i>	
<i>Adresa e operatorit të ri të parazgjedhur:</i>	
<i>Emri i Operatorit Ofrues të Aksesit në linjën telefonike:</i>	
<i>Adresa e operatorit të aksesit në linjën telefonike:</i>	
<i>Lloji i thirrjeve për të cilat autorizohet ndryshimi i bartësit të parazgjedhur:</i>	<input type="checkbox"/> <b>Kombëtare</b> <input type="checkbox"/> <b>Ndërkombëtare</b> <input type="checkbox"/> <b>Kombëtare dhe Ndërkombëtare</b> <input type="checkbox"/> <b>Të gjitha thirrjet</b>
<i>Data e preferuar/kërkuar për ndryshimin e bartësit të parazgjedhur</i>	____.____.20____

Nëpërmjet nënshkrimit të këtij formulari deklaroj si më poshtë:

1. përdor shërbimin telefonik për numrin/numrat e sipërsënuar të telefonit në rrjetin e operatorit të rrjetit të aksesit të linjës telefonike (*vendos emrin e operatorit të rrjetit të aksesit*) dhe dëshiroj që të anullos parazgjedhjen e bartësit për thirrjet e përcaktuara me sipër, që aktualisht barten nga operatori i parazgjedhur (*vendos emrin e operatorit të parazgjedhur*), për të kaluar tek operatori i ri i parazgjedhur (*vendos emrin e operatorit të ri parazgjedhur*)
2. Autorizoj operatorin e parazgjedhur (*vendos emrin e operatorit të parazgjedhur*) dhe operatorin e rrjetit të aksesit (*vendos emrin e operatorit të rrjetit të aksesit*) të shkëmbejnë informacionin personal, qe është i nevojshëm për të anuluar PB.
3. Autorizoj operatorin e ri të parazgjedhur (*vendos emrin e operatorit të ri parazgjedhur*) që në emrin tim, të dërgojë kërkesën time operatorit të rrjetit të aksesit të linjës telefonike (*vendos emrin e operatorit të rrjetit të aksesit*) dhe operatorit të parazgjedhur (*vendos emrin e operatorit të parazgjedhur*) për ndryshimin e operatorit të parazgjedhur sipas zgjedhjeve në formularin e nënshkruar.

Pajtimtari:

\_\_\_\_\_  
(Vendi dhe data)

\_\_\_\_\_  
(Nënshkrimi)

Operatori i Ri i Parazgjedhur:

Firma dhe Vula Zyrtare e Operatorit

**Formular Aplikimi  
për  
Caktimin e Prefiksit për Zgjedhjen e Bartësit**

**I. Të dhëna për aplikantin:**

Emri i aplikantit:	
Adresa:	
Numri i regjistrimit (NIPT):	

Kutia Postare: .....

Nr. Telefonit: .....

Nr. faksit: .....

E -mail : .....

Personi i kontaktit: ..... Tel: .....

**II. Informacion për Kushtet për tu pajisur me prefiksin për zgjedhjen e bartësit:**

1. Jam i Regjistruar të ofroj rrjet publik telefonik dhe shërbime publike telefonike

*Vendosni referencën (numrin) në Rregjistrin e Sipërmarrësve që kanë njoftuar për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të Komunikimeve elektronike publike sipas regjimit të autorizimit të përgjithshëm : .....*

2. Zotëroj faqe interneti aktive në domain “.al”:

*Vendosni adresën e plotë të faqes së internetit (duhet të jetë aktive): .....*

3. Jam pajisur me Kod Pike Sinjalizimi Kombëtare (NSPC)/Ndërkombëtare (ISPC) :

*Vendosni pikat e sinjalizimit kombëtar dhe/ose ndërkombëtar të caktuar nga AKEP .....*

4. Zotëroj kapacitete teknike dhe menaxhuese për zbatimin e kërkesave të kaudrit ligjor dhe rregullator për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve publike telefonike, përfshirë midis të tjerave:

- faturimin e detajuar të pajtimtarit;*
- realizimin e treguesve të cilësisë sipas Rregullores së AKEP “Për treguesit e Cilësisë”*
- zbatimin e rregullave për portabilitetin e numrit sipas Rregullave të përcaktuara nga AKEP;*
- zbatimin e standarteve dhe rekomandimeve të ITU, IEEE, RIPE NCC, etj*

- garantimin e CLI transparent, dhe kushteve për paraqitjen e CLI*
- kërkesat e ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.*
- kërkesat ligjore në lidhje me përgjimin e ligjshëm për të gjitha thirrjet që do të kalojnë në sistem.*

*mosprishja e cilësisë së bisedës, garantimi i sigurisë së thirrjeve nëpërmjet rrugëve të mbrojtura,*

**III. Argumentoni përse kërkoni caktimin e prefiksit për zgjedhjen e bartësit:**

.....  
 .....  
 .....

**IV. Preferenca për Prefiksin për Zgjedhjen e Bartësit:**

Ju lutem vendosni preferencat tuaja për Prefiksin:

<b>Preferenca</b>	<b>Prefiksi (dy shifra pas 10)</b>
Alternativë e parë	<b>10__</b>
Alternativë e dytë	<b>10__</b>
Alternativë e tretë	<b>10__</b>

**V. Data e planifikuar për vënien në shërbim të prefiksit për zgjedhjen e bartësit:**

.....

Me nënshkrimin e këtij formulari deklaroj se të gjitha të dhënat dhe deklaratimet janë të sakta.

Data e aplikimit: .....

Nënshkrimi i Aplikantit: .....

Firma dhe Vula Zyrtare e Operatorit



**AUTORITETI KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

**Implementimi i Zgjedhjes së Bartësit dhe**

**Parazgjedhjes së Bartësit**

(Miratuar me VKD nr.1650, datë29.06.2011)

# **Përmbajtja**

- 1. HYRJE**
- 2. PËRSHKRIMI I SHËRBIMEVE TË ZGJEDHJES DHE PARA-ZGJEDHJES SË BARTËSIT**
- 3. BAZA LIGJORE DHE VENDIMET PËR FNT**
- 4. PËRVOJA NË RAJON DHE NË VENDET E BE**
- 5. SKEMAT E PROPOZUARA PËR ZGJEDHJEN DHE PARA-ZGJEDHJEN E BARTËSIT**
- 6. PROBLEME TË PËRDORUESIT**
- 7. ALOKIMI I KODEVE TË NUMERACIONIT PËR ZGJEDHJEN E BARTËSIT**

# 1. Hyrje

Zgjedhja e Bartësit (ZB) dhe Para-zgjedhja e Bartësit(PB)<sup>1</sup> i krijon mundësinë përdoruesve fundorë të një rrjeti të komunikimeve telefonike publike që duke përdorur linjën telefonike të operatorit të rrjetit publik telefonik (ofruesi i aksesit) me të cilin kanë një kontratë pajtimi, të zgjedhin vetë ofruesin e thirrjeve telefonike që i konsiderojnë më të mirat për nevojat e tyre, veçanërisht për sa i përket çmimit dhe cilësisë së thirrjeve telefonike. Kjo mundësi për përdoruesit fundorë të një rrjeti publik telefonik, krijon mundësinë për ofruesit e thirrjeve telefonike, të ndryshëm nga operatori i rrjetit me të cilin përdoruesi ka një kontratë pajtimi për linjën telefonike, që tu ofrojnë këtyre përdoruesve thirrje telefonike duke përdorur të njëjtën linjë telefonike. Në këtë mënyrë krijohet mundësia për një konkurrencë më të madhe midis operatorëve për ofrimin e thirrjeve telefonike duke rritur përfitimet e përdoruesve fundorë për tarifa më të lira për thirrjet telefonike.

Objektivi këtij dokumenti është dhënia e informacionit udhëzues për palët e interesuara për mënyrën e implementimit të Zgjedhjes së Bartësit dhe Para-zgjedhjes së Bartësit dhe përfshin trajtimin e çështjeve të tilla si përshkrimi i shërbimeve të Z(P)B dhe skemat e funksionimit, detyrimet për ofrimin e Z(P)B nga një operator me FNT, përvoja në vëndet e rajonit dhe të BE me Z(P)B si dhe probleme të mundshme për përdoruesit në këtë proces. Ky dokument është përgatitur pas konsultimit publik me palët e interesuara. Sipërmarrësit duhet t'i referohen edhe dokumentit të Rregullores për Zgjedhjen e Bartësit dhe Para-zgjedhjes së Bartësit, për të qartësuar të drejtat dhe detyrimet e tyre për Z(P)B si operator bartës i thirrjeve dhe si operator rrjeti aksesi që ka detyrimin për të dhënë akses për Z(P)B.

---

<sup>1</sup> Në anglisht Carrier (Pre) Selection - C(P)S

## **2. Përshkrimi i Shërbimeve të Zgjedhjes dhe Para-zgjedhjes së Bartësit**

Zgjedhja dhe Para-zgjedhja e Bartësit është një facilitet që i jep pajtimtarëve të lidhur në rrjetin telefonik publik të një operatori mundësinë e zgjedhjes që disa ose të gjitha thirrjet e tij telefonike të barten nga një operator tjetër. Kur një pajtimtar përdor Z(P)B, thirrja rrugëzohet për në destinacion nëpërmjet operatorit të zgjedhur dhe jo nëpërmjet operatorit ku pajtimtari është fizikisht i lidhur. Thirrjet e kryera nëpërmjet Z(P)B faturohen sipas tarifave të ofruara nga operatori i zgjedhur dhe jo sipas tarifave të ofruara nga operatori që i ofron akses në rrjet pajtimtarit. Për ofrimin e këtij shërbimi ndaj përdoruesit fundor përdoret :

- infrastruktura e operatorit të rrjetit të aksesit (linja fizike që lidh pajtimtarin me operatorin e rrjetit të aksesit) që shërben për të realizuar një pjesë të thirrjes (deri në pikën e interkoneksionit midis operatorit të rrjetit të aksesit me operatorin e (para)zgjedhur) dhe për këtë shërbim pagesat kryhen midis operatoreve, pasi është shërbim me shumicë i ofruar nga operatori i rrjetit të aksesit për operatorin e zgjedhur ;
- infrastruktura e operatorit të zgjedhur i cili pasi merr thirrjen në pikën e interkoneksionit me operatorin e rrjetit të aksesit e dërgon atë në destinacion (numri i thirrur nga pajtimtari).

Pajtimtari ka detyrime ndaj operatorit të rrjetit që zotëron linjën telefonike vetëm për pajtimin mujor dhe thirrjet telefonike të faturuara prej tij (rasti i ZB), ndërsa ndaj bartësit të thirrjeve (me parazgjedheje ose me zgjedhje në cdo thirrje) për thirrjet e rrugëzuar nga ai bartës.

Ky facilitet i jep mundësinë operatorëve të cilët nuk kanë përdorues të tyre të lidhur direkt me ta, t'u ofrojnë shërbime pajtimtareve të cilët janë të lidhur direkt me një operator tjetër. Operatorët me pajtimtarë të lidhur direkt me ta gjithashtu mund të ofrojnë shërbime pajtimtareve të tjerë si rezultat i përdorimit të zgjedhjes së bartësit.

Për zbatimin e Z(P)B ekzistojnë tre mundësi teknike:

### **2.1 Zgjedhja e Bartësit në fillim të thirrjes (Call-by-call Carrier Selection-CS)**

Zgjedhja e Bartësit në fillim të thirrjes (më poshtë Zgjedhja e Bartësit-ZB) i referohet mundësisë që i krijohet përdoruesit për të zgjedhur operatorin në fillim të thirrjeve gjatë formimit të numrit. Zgjedhja zakonisht përcaktohet nëpërmjet vendosjes së prefiksit për zgjedhjen e bartësit (10xx) përpara shifrave të numrit që duhet të formohet për të realizuar thirrjen normale pa zgjedhje të bartësit.

Operatori që i ofron pajtimtarit aksesin në rrjet analizon prefiksin e formuar (10xx ku xx janë shifrat që identifikojnë operatorin e zgjedhur) dhe rrugëzon thirrjen drejt operatorit nëpërmjet

pikës më të afërt të interkoneksionit që ka me këtë operator. Pastaj është përgjegjësia e operatorit të zgjedhur që të kontrollojë nëse pajtimtari është i autorizuar të përdorë këtë shërbim, të çojë thirrjen në destinacionin e zgjedhur si dhe të bëjë faturimin e përdoruesit për thirrjen, përfshirë procesin e pagesës së pajtimtarit për shërbimin e kryer.

## **2.2 Para-Zgjedhja e Bartësit (Carrier Pre-Selection-CPS)**

Në shërbimin e Para-Zgjedhjes së Bartësit, pajtimtari zgjedh bartësin (sipas procesit të shpjeguar më poshtë) për të gjitha thirrjet që do të kryejë dhe në centralin e operatorit që i ofron aksesin në rrjet pajtimtarit, sipas zgjedhjes së pajtimtarit, programohet si default ky operator i zgjedhur për thirrjet e pajtimtarit. Para-zgjedhja e këtij bartësi mund të kryhet për lloje të caktuara të thirrjeve sipas kategorive (lokale, kombëtare drejt fiks apo celulare dhe ndërkombëtare) ose për të gjitha thirrjet ('all calls' option) dhe për llojet e zgjedhura të thirrjeve nuk nevojitet të formohet prefiksi i bartësit përpara formimit të numrit të thirrur (ai është programuar në central) si në rastin e zgjedhjes së bartësit në fillim të thirrjes. Para-Zgjedhje e Bartësit programohet në central nga operatori që ofron linjën e aksesit në rrjet me procedura të veçanta për çdo linjë/operator të para-zgjedhur.

## **2.3 Para-Zgjedhja e Bartësit me shmangie (ri-zgjedhje) (Carrier Pre-Selection with override)**

Në këtë rast, operatori i para-zgjedhur funksionon si në rastin më sipër me përjashtim të rasteve kur përdoruesi për thirrje të veçanta e shmang atë duke formuar prefiksin e zgjedhjes së bartësit (10xx) përpara numrit që thirret. Në këtë rast kemi kombinimin e dy rasteve të para të përmendura më lart.


Z(P)B është ngjashme me shërbimin e kartave me parapagim që i ofrohen aktualisht abonentëve të telefonisë fikse, ku abonentët para thirrjes u duhet të formojnë një kod 0801xxx, me ndryshimin që:

- Pajtimtarët ZB mund të formojnë prefiksi e zgjedhjes së bartësitn 10xx, (i cili është më i shkurtër se kodi i aksesit 0801xxx i OSHKP-ve) si dhe mund të formojnë direkt numrin e thirrur menjëherë pas formimit të prefiksit për zgjedhjen e bartësit pa qënë nevoja të presin konfirmim, gjëndjen e kreditit, etj. si në rastin e platformës me parapagim OSHKP
- Pajtimtarët PB nuk kanë fare nevojë të formojnë prefiksin për zgjedhjen e bartësit para thirrjes si në rastin e ZB apo kodin e aksesit si në rastin e OSHKP;
- Pajtimtarët Z(P)B nënshkruajnë kontratë me bartësin e thirrjeve dhe marrin faturë prej tij, pra nuk është shërbim me parapagim.

Tre opsionet e mësipërme paraqiten skematikisht në figurën e mëposhtëme për rastin e thirrjeve ndërkombëtare. Skema funksionon në të njëjtën mënyrë edhe për thirrjet kombëtare me ndryshimin që pala e thirrur është në rrjetin e një operatori në Shqipëri.



## 2.4 Zgjedhja e Bartësit dhe Para-Zgjedhja e Bartësit për Thirrjet Ndërkombëtare



### **Skenari aktual:**

#### Numerformimi :

*Prefiksi ndërkombëtar + Numri i thirrur  
thirrje ndërkombëtare nga PSTN, rrugëzimi i thirrjes: 1→2→3*

### **Zgjedhja e Bartësit:**

#### Numerformimi :

*Prefiksi i Zgjedhjes së Bartësit+Prefiksi ndërkombëtar + Numri i thirrur  
thirrje ndërkombëtare nga PSTN, rrugëzimi i thirrjes: 1→4→5→3*

### **Para-Zgjedhja e Bartësit**

#### Numerformimi :

*Prefiksi ndërkombëtar + Numri i thirrur  
thirrja rrugëzohet automatikisht nëpërmjet bartësit ndërkombëtar të para-  
zgjedhur*

### **Para-Zgjedhja e Bartësit me shmangie (ri-zgjedhje):**

#### Z(P)B:

#### Numerformimi :

*Prefiksi ndërkombëtar + Numri i thirrur  
thirrja rrugëzohet automatikisht nëpërmjet bartësit ndërkombëtar të para-  
zgjedhur*

#### ZB

#### Numerformimi :

*Prefiksi i Zgjedhjes së Bartësit + Prefiksi ndërkombëtar + Numri i thirrur*

## **2.5 Marrëdhëniet midis palëve për pagesat**

### **2.5.1 Pajtimtari me operatorët:**

Në të gjitha rastet pajtimtari duhet të paguajë operatorin e rrjetit që zotëron linjën telefonike, tarifën për pajtimin mujor sipas kontratës që ka më këtë operator.

ZB: Pajtimtari paguan për thirrjet që ka kryer me ZB operatorin e zgjedhur në fillim të thirrjeve të kryera me këtë prefiks për zgjedhjen e bartësit, dhe paguan operatorin e rrjetit të aksesit (linjës telefonike) thirrjet që i ka kryer normalisht pa ZB.

PB: Pajtimtari paguan operatorin e parazgjedhur për thirrjet telefonike dhe operatorin e rrjetit për pajtimin mujor. Pagesat për thirrjet për operatorin e parazgjedhur janë për ato thirrje që është parazgjedhur, të cilat mund të grupohen në:

- Thirrje kombëtare,
- Thirrjet ndërkombëtare,
- Thirrje kombëtare dhe thirrjet ndërkombëtare,
- Të gjitha thirrjet.

PB me rizgjedhje: Pajtimtari paguan për thirrjet telefonike operatorin e parazgjedhur, përveç thirrjeve që ka bërë më ZB, të cilat i paguhen këtij/këtyre të fundit.

### **2.5.2 Operatori i zgjedhur (parazgjedhur) me operatorin e rrjetit**

Operatori i zgjedhur/parazgjedhur duhet të ketë një marrëveshje interkoneksioni me operatorin e rrjetit që zotëron linjën telefonike të pajtimtarit dhe i paguan këtij operatori:

- Tarifën për origjinimin e thirrjeve në bazë të tarifave të përcaktuara në RIO;
- Tarifë për implementimin e PB (tarifë fikse për programimin e centralit për çdo pajtimtar që parazgjedh operatorin) e përcaktuar në RIO.

## **3. Baza ligjore dhe vendimet për FNT**

Ligji nr.9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 43 përcakton se, AKEP ka të drejtë të vendosë detyrimin për zgjedhjen e bartësit dhe parazgjedhjen e bartësit (në vijim referuar shkurtimisht Z(P)B), sipërmarrësve me fuqi të ndjeshme në tregun përkatës të lidhjes në rrjetin telefonik publik dhe përdorimit të tij, që t’u mundësojnë pajtimtarëve të tyre aksesin në shërbimet e çdo ofruesi të shërbimeve telefonike të disponueshme për publikun, me të cilët janë të interkonektuar, nëpërmjet zgjedhjes ose parazgjedhjes së bartësit. Në këtë nen përcaktohet se tarifat për ofrimin e këtij shërbimi duhet të jenë të orientuara në kosto si dhe detyrimi për Z(P)B mund t’u vendoset edhe sipërmarrësve të tjerë (jo me FNT).

AKEP me Vendimin nr.1348, date 26.07.2010, për “Percaktimin e Sipërmarrësit Albtelcom Sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese në tregjet me pakicë të

*telefonisë fikse dhe tregjet me shumicë të interkoneksionit të telefonisë fikse” në pikën 4.3 ka vendosur detyrimin për Sipërmarrësin Albtelecom që t’u ofrojë pajtimtarëve të tij mundësinë e zgjedhjes/parazgjedhjes së bartësit të thirrjeve dhe të bëjë përditësimin e ofertes referencë të interkoneksionit sipas përcaktimeve të një vendimi të veçantë të AKEP për këtë detyrim (pika 4.5.3 e Vendimit nr. 1348).*

AKEP, nëpërmjet këtij dokumenti, dhe vendimit përkatës për miratimin e tij, ka vendosur për mënyrën e implementimit efektiv të këtij detyrimi nga Albtelecom. Implementimi i këtij detyrimi do të kryhet nga Albtelecom sipas përcaktimeve në këtë dokument si dhe sipas rregullores së Z(P)B. Për rregullimin e marrëdhënieve me operatorët bartës të thirrjeve Albtelecom do të duhet të kryejë amendimin e RIO-s, për përfshirjen e shërbimit Z(P)B në RIO.

Sipas përcaktimit të Ligjit 9918, detyrimi për të dhënë akses për Z(P)B mund të vendoset edhe për operatorë të tjerë fikse apo celularë, me FNT ose jo. Shtrirja e këtij detyrimi edhe për operatorë të tjerë, përveç Albtelecom do të merret në konsideratë nga AKEP në periudha të mëvonshme, pasi ky shërbim të jetë implementuar në mënyrë të suksesshme fillimisht nga Albtelecom. Kjo zgjedhje e AKEP, bazohet edhe në praktikat në vendet e tjera të referuara në seksionin 4 më poshtë. Rregullorja e përgatitur për Z(P)B është e përgjithshme duke mos specifikuar operatorin që ofron akses për Z(P)B, pra mund të përdoret edhe për operatorë të tjerë, nëse AKEP gjykon se ky detyrim është i justifikueshëm për tu vendosur për këta operatorë të tjerë, fikse apo celularë, me FNT ose jo. Siç është cituar më poshtë, megjithëse në ligjin 9918, ka hapësira që detyrimi për Z(P)B të vendoset edhe ndaj operatorë të tjerë, fikse apo celularë, me FNT ose jo, në rekomandimet e KE të vitit 2002 ky detyrim është parashikuar për operatorët me FNT në telefoninë fikse, megjithëse rekomandimi lë të hapur mundësinë për vendosjen e detyrimit edhe për operatorët celularë. Në bazë të parimeve të rregullimit të KE, detyrimi për Z(P)B vendoset në kushte e FNT në një treg me pakicë të thirrjeve telefonike, dhe duke qënë se në tregun celular aktualisht nuk ka operatorë me FNT në tregun me pakicë të thirrjeve telefonike, kjo masë nuk gjykohet e arsyeshme për t’u vendosur ndaj operatorëve celularë.

#### **4. Përvoja në rajon dhe në vendet e BE**

Parlamenti dhe Këshilli European në direktivën e shërbimit universal (DIRECTIVE 2002/22/) në nenin 19 shprehen se rregullatori duhet t’i kërkojë sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme për ofrimin e lidhjes dhe përdorimit të rrjetit publik nga një vendodhje fikse, që t’u mundesojë pajtimtarëve të tij aksesin në përdorimin e shërbimeve të ofruara nga ofruesit e shërbimeve publike telefonike të interkonektuar me të, nëpërmjet zgjedhjes së bartësit në fillim të thirrjes dhe parazgjedhjes së bartësit me mundësinë e rizgjedhjes. Në vendet e BE, Z(P)B është implementuar plotësisht, madje në shumë vende është trajtuar dhe vendosur detyrimi për “dhënie me qera të linjave telefonike me shumicë (WLR-Wholesale Line Rental), e cila bën të mundur që tarifimi i shërbimeve të pajtimtarit, përfshirë pajtimin mujor, që kryhet nga operatori i para-zgjedhur (kur është parazgjedhur për të gjitha thirrjet) dhe ky i fundit i paguan operatorit të rrjetit që zotëron linjën telefonike një tarifë me shumicë për pajtimin mujor (qeranë) e linjes telefonike (përveç pagesave të tjera të origjinimit të thirrjeve dhe programimit për PB). Tarifimi për pajtimin mujor WLR është rreth 11 euro/muaj që është disi më i lartë se niveli i tarifës për LLU (8.5 euro/muaj) dhe më i ulët se niveli i tarifës me pakicë të pajtimin mujor (rreth 15 Euro me TVSH).

Në rajonin e Europës juglindore, rezulton se shërbimi i Z(P)B është implementuar në Kroaci, Maqedoni, Mal të Zi, Turqi dhe Bosnjë Hercegovinë dhe nuk është implementuar ende në Shqipëri, Serbi dhe Kosovë:

- Kroaci: Implementimi i PB për operatorin inkumbent fiks ka filluar në vitin 2005 dhe i ZB në 2006 për të gjitha llojet e thirrjeve: lokale, kombëtare, drejt celulareve dhe ndërkombëtare. Aktualisht janë 5 ofrues Z(P)B.
- Maqedoni: Shërbimet Z(PB) kanë filluar në vitin 2007 për thirrjet kombëtare, ndërkombëtare dhe drejt celulareve dhe në 2008 për thirrjet lokale. Vetëm, një operator alternative ofrues i Z(P)B. Maqedonia është i vetmi vend në rajon që ka vendosur edhe WLR.
- Turqi: Ka filluar në vitin 2006 për thirrjet kombëtare, ndërkombëtare dhe drejt celulareve dhe në 2009 për thirrjet lokale.
- BH: Ka filluar në vitet 2006-2007.
- Mali i Zi: Detyrimi është vendosur në Dhjetor 2007 ndaj të gjithë rrjeteve fiks dhe celular, por është efektiv vetëm në operatorin fiks inkumbent.
- Sërbia: Nuk ka vendosur ende kete detyrim ndërsa në Kosovë detyrimi është vendosur në Qershor 2010 por nuk është implementuar ende.

Për sa i përket tarifave të aplikuara nga operatori incumbent për ofrimin e Z(P)B operatoreve të tjere, ato përfshijnë gjithmonë tarifimin për origjinimin thirrjeve në nivele të njejta me tarifën e terminimit si dhe tarifa për programimin e centralit/centraleve për PB të cilat mund të jenë për çdo linjë dhe/ose për operator.

## **5. Skemat e propozuara për Zgjedhjen dhe Para-zgjedhjen e Bartësit**

Nga praktika në vende të tjera të rajonit dhe BE, vihet re se implementimi i këtij detyrimi në shumë raste është bërë me faza për lloje të caktuara thirrjesh dhe/ose ZB dhe PB në faza të ndryshme.

Bazuar në këto praktika dhe kompleksitetin e implementimit të Z(P)B për të gjitha kategoritë e thirrjeve, AKEP propozon që implementimi i këtij detyrimi të fillojë njëkohësisht për ZB dhe PB (përfshirë detyrimin për mundësimin e ZB kur ka PB: PB me rizgjedhje) dhe fillimisht vetëm për thirrjet ndërkombëtare duke implementuar në një fazë të dytë llojet e tjera të thirrjeve si kombëtare drejt fiks, kombëtare drejt celulareve dhe thirrjet lokale. Implementimi i Z(P)B nuk është një proces i thjeshtë dhe kërkon punë programuese nga Albtelcom në centralet dhe sistemet e billing-ut për pajtimtarët dhe operatorët, si dhe operatorët bartës të thirrjeve do të duhet të kenë sisteme billing-u dhe marrëdhënie me pajtimtarët. Skema bëhet më komplekse me rritjen e numrit të kategorive të thirrjeve për Z(P)B. Aplikimi i skemës në fazën e parë vetëm për thirrjet kombëtare, rrit mundësitë e implementimit me sukses të Z(P)B, dhe së bashku me progresin në orientimin në kosto të tarifave të interkoneksionit dhe tarifave me pakicë të Albtelcom (ribalancimi), bën më të lehtë përfshirjen e kategorive të tjera të thirrjeve në Z(P)B. AKEP,

bazuar edhe në komentet e marra gjatë konsultimit publik të këtij dokumenti si dhe masat e tjera rregulluese që janë vendosur ndaj Albtelecom, gjykon se implementimi i dy fazave të kryhet si vijon:

- Faza e I: duke filluar nga 15.10.2011.

Deri më 30.07.2011, Albtelecom duhet të ketë depozituar në AKEP propozimin për amendimin RIO për përfshirjen e shërbimeve të Z(P)B. Albtelecom duhet të kryejë deri në 15.10.2011 përgatitjet e nevojshme teknike për implementimin e Z(P)B për pajtimtarët e vet (Familjare dhe Të tjerë) dhe marrdhëniet me bartësit e thirrjeve.

- Faza e dyte: duke filluar nga 1.05.2012.

Albtelecom deri më 1.05.2012 duhet të kryejë të gjitha përgatitjet e nevojshme teknike për të implementuar me sukses Z(P)B për të gjitha llojet e thirrjeve.

Rregullorja e përgatitur ka parashikuar 4 opsione për Z(P)B:

- a. Thirrje ndërkombëtare
- b. Thirrje kombëtare
- c. Thirrje kombëtare dhe ndërkombëtare
- d. Të gjitha thirrjet.

Meqënëse rregullorja është e përgjithshme, ajo nuk përmban emra të operatorëve ndaj të cilëve aplikohet detyrimi për të dhënë akses për C(P)S (p.sh.Albtelcom aktualisht) apo fazat e implementimit të propozuara më sipër. Sipas skemës së propozuar, detyrimi për të dhënë akses për Z(P)B do të funksionojë fillimisht për Albtelecom duke filluar nga 15.10.2011 për alternativën 'a' dhe disponibiliteti i alternativave 'c-d' do të jete i mundur vetëm duke filluar nga data 1.05.2012. Llojet e thirrjeve të përfshira në secilën alternative, janë dhënë në nenin 2 të rregullores.

Rregullorja sqaron se pajtimtari ka të drejtë të parazgjedhë një bartës për alternativën 'a' dhe një bartës tjetër për 'b', ose të njëjtin bartës për 'a' dhe 'b' (d.m.th alternativën 'c'). Për alternativën 'd' pajtimtari mund të parazgjedhë vetëm një operator bartës dhe nuk mund të parazgjedhë bartës të tjerë për alternativat e tjera të thirrjeve. Në secilin prej rasteve të mësipërme pajtimtari ka të drejtë të përdorë edhe zgjedhjen e bartësit në fillim të thirrjes duke formuar prefiksin përkatës.

Ndërkohë, vendosja e detyrimit për dhënie me qera me shumicë të linjës telefonike (WLR) do të vlerësohet nga AKEP në një fazë të mëvonshme pas implementimit të Z(P)B sipas skemës së propozuar (të paktën pas fazes së parë), pasi për momentin gjykohet se vendosja e këtij detyrimi do të rriste kompleksitetin e procesit.

Tarifimi për origjinimin e thirrjeve nga Albtelecom për bartësit e thirrjeve do të kryhet në nivel të njëjtë me tarifën respektive në fuqi të terminimit të thirrjeve në rrjetin Albtelecom. Ndërkohë procesi i Z(P)B gjeneron kosto fikse për operatorin e rrjetit (Albtelcom) të nevojshme për

programimin për implementimin e ZB dhe të PB, si dhe kosto për administrimin e kërkesave. Nga të dhëna në oferta refernce të operatoreve incumbent vihet re se tarifa të tilla përfshijnë:

- Tarifë për implementimin e prefiksi të zgjedhjes së bartësit (ZB). Paguhet një herë dhe në bazë të numrit të centraleve ku implementohet;
- Tarifë për implementimin e PB: paguhet një herë dhe mund të jetë për implementimin në të gjithë centralet ose e shprehur në tarifë për central.
- Tarifë për implementimin e PB për cdo linjë telefonike: kjo tarifë paguhet një here nga bartësi i thirrjeve për cdo pajtimtar që perdor PB.

Aplikimi i ketyre tarifave (përvec tarifave të origjinimit) dhe niveli i tyre, do të jenë objekt i shqyrtimit dhe miratimit të AKEP në vendim-marrjen për miratimin e propozimit të Albtelcom për amendimet e RIO-s së Albtelcom për përfshirjen e shërbimit të Z(P)B në këtë RIO..

## **6. Probleme të mundshme për përdoruesit**

Siç vihet re nga përshkrimi i shërbimeve të Z(PB, pajtimtarët që do të përdorin Z(P)B do të duhet të paguajnë të paktën dy fatura për shërbimet telefonike dhe numri mund të jetë më i madh nëse pajtimtari përdor PB me rizgjedhje dhe/ose zgjedh/parazgjedh disa operatore për thirrjet telefonike. Në këtë mënyrë pajtimtari i Albtelcom do të tarifohet nga Albtelcom për pajtimin mujor si dhe për thirrjet e kryera normalisht pa Z(P)B. Për thirrjet e kryera me Z(P)B pajtimtari do të tarifohet dhe faturohet nga operatori i zgjedhur apo i parazgjedhur, dhe për këtë do të jetë e nevojshme nënshkrimi i një kontrate midis pajtimtarit dhe operatorit të zgjedhur/parazgjedhur.

Marrëveshjet për faturimin janë pjesë e diskutimit dhe marrëveshjeve ndërmjet operatorëve si pjesë e negociatave për marreveshjet e tyre të interkoneksionit.

Mënyra e pagesës mund të zgjidhet nga palët dhe sipas mundësive teknike pa deformuar skemën e funksionimit të shërbimeve dhe kosto shtesë për pajtimtarin. Pajtimtari ka të drejtë të zgjedhë apo parazgjedhë disa operatorë. Për parazgjedhjen ai ka mundësi të zgjedhë operatorë të ndryshëm për lloje të ndryshme thirrjesh por jo operatorë të ndryshëm për të njëjtën lloj thirrjeje.

Marrëdhëniet midis pajtimtarit dhe operatorit të zgjedhur me Z(P)B rregullohen nëpërmjet një kontrate të nënshkruar nga të dy palët dhe termat e përgjithshme të kësaj kontrate duhet të jenë të miratuara nga AKEP. Kontrata do të duhet të përmbajnë të gjitha përcaktimet e dhëna në Ligjin nr. 9918, dhe operatori i zgjedhur duhet të publikojë tarifat për shërbimet e ofruara duke i përfshirë ato edhe në kontratën e lidhur. Këto tarifa nuk janë nën-rregullim.

Rregullorja përmban një sërë kushtesh për tu aplikuar nga operatorët për ofrimin e Z(P)B me qëllim informimin e pajtimtarëve, dhe mbrojtjen e tyre nga praktikat abusive, përfshirë detyrimin për publikimin e termave të përgjithsme dhe tarifave në faqen e internetit të bartësve të thirrjeve, e cila do të duhet të jetë në domain “.al”.

Një praktikë që është vënë re në vendet që kanë implementuar Z(P)B është inicimi apo ndryshime në Z(P)B pa pëlqimin e pajtimtarit. Kjo praktikë referohet si ‘slamming’ dhe përbën praktikë abuzive të një operatori që dëmton pajtimtarin, operatorë të tjerë si dhe besimin e pajtimtarëve në Z(P)B. Ndër këto praktika mund të përmendim:

- Pajtimtari mund të jetë duke plotësuar një formular për qëllime të tjera si pjesmarrje në llotari apo abonim në revista, dhe ky formular mund të përmbajë një autorizim për ndryshim të bartësit.
- Pajtimtarët kontaktohen me telefon duke i kërkuar ndryshimin e bartësit të thirrjeve, pa nënshkruar autorizimin apo kontratën.
- Një bartës thirrjesh mund të kontaktojë operatorin e rrjetit të aksesit duke pretenduar se është pajtimtar i tij dhe kërkon ndryshimin e bartësit.

AKEP bazuar në këto praktika të mundshme të pandershme dhe duke marrë shkas nga komentet e operatorëve, ka bërë përcaktime në rregullore që mundohen të shmangin këto praktika sic është domosdoshmëria e nënshkrimit të formularit nga pajtimtari dhe shkëmbimi i formularëve origjinalë të nënshkruar nga pajtimtari midis operatorëve, aplikimi i parimit ‘one stop shop’ etj.

Megjithatë, AKEP gjykon se operatorët duhet të marrin masa që praktika të tilla të mos ndodhin apo të minimizohen dhe të vënë në dijeni AKEP për cdo operator që përfshihet në praktika të tilla.

Gjithashtu AKEP do të publikojë një udhëzues me të detajuar për konsumatorët për përdorimin e Z(P)B.

## **7. Përcaktimi i numeracionit për Zgjedhjen e Bartësit**

AKEP mendon që të gjithë operatorët që ofrojnë rrjete publike telefonike të autorizuar nga AKEP, duhet të jenë në gjëndje që të përdorin prefiksin për zgjedhjen e bartësit në mënyrë që të ofrojnë shërbimet e rrjetit të tyre mbi bazën e zgjedhjes për çdo thirrje(call-by-call) apo me parazgjedhje.

Përcaktimi i numeracionit për Zgjedhjen e Bartësit nuk duhet të krijojë vështirësi për përdoruesin për një akses eficient në këtë shërbim. Plani Kombëtar i Numeracionit për Shqipërinë përcakton përdorimin e prefiksit për zgjedhjen e bartësit në formatin ‘10xx’ Ky format i prefiksit lehtëson konkurrencën në treg për Zgjedhjen e Bartësit. Fillimisht prefikset 10x0 nuk do të përdoren. Kjo zgjedhje bëhet për të shmangur konfuzionin kur kodi i aksesit të bartësit ndiqet nga prefiksi ndërkombëtar (00).

Procedura e aplikimit dhe caktimit të prefiksit për zgjedhjen e bartësit, janë dhënë rregulloren për Z(P)B. Bazuar në komentet e palëve te interesura, AKEP ka përcaktuar në këtë rregullore disa detyrime që duhet të plotësojnë operatorët që do të pajisen me prefiksit për zgjedhjen e bartësit, të cilat janë përfshirë në formularin për aplikimin për prefiks për zgjedhjen e bartësit.